



RRITJA E NJOHURIVE TË OMSHC-ve MBI LEGJISLACIONIN KOMBËTAR, PËRGJEGJËSITË DHE DETYRIMET PËR ZBATIMIN E TIJ NË FUSHËN E RUAJTJES SË MJEDISIT DHE BURIMEVE NATYRORE

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

TIRANË, më 07.03.2022

Publikuar nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Rr. Islam Alla, Pall. IVEA, kati i 1, Tirana

Tel/fax: +355 42231437

<http://www.inca-al.org>

E-mail: info@inca-al.org

Materiali është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC).

Përmbajtja është përgjegjësi e INCA dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e LëvizAlbania dhe të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	4
1. VËSHTRIM I SHKURTËR MBI KUADRIN LIGJOR MJEDISOR NË SHQIPËRI	6
2. LEGJISLACIONI PËR RUAJTJEN E MJEDISIT DHE NATYRËS NË PAJTIM ME KËRKESAT E BE-së	10
2.1 Ligj nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".	10
2.2 Ligj nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"	11
2.3 Ligj nr. 91, datë 28.02.2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor"	13
2.4 Ligj nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit".	14
2.5 Ligj nr.81, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura"	16
2.6 Ligj nr.10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër".	20
2.7 Ligj nr. 57, datë 30.04.2020 "Për pyjet"	22
2.8 Ligj nr.10253, datë 11.03.2010 "Për gjuetinë"	25
2.9 Ligj nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor".	26
2.10 Ligj nr.10120, datë 23.4.2009 "Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore".	27
2.11 Ligj nr.64, datë 31.5.2012 "Për peshkimin".	28
2.12 Ligj nr.111, datë 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".	30
2.13 Ligj nr. 8905, datë 06.06.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi".	33
2.14 Ligj nr.93, datë 27.07.2015 "Për turizmin".	33
2.15 Ligj nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".	35
2.16 Ligj nr.107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".	37
2.17 Ligj nr. 139, datë 17.12. 2015 "Për vetëqeverisjen vendore"	40
2.18 Ligj nr. 7895, datë 27.01.1995 "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË".	42

HYRJE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë për ndërtimin e një qytetarie (lëvizje komunitare) aktive, partnere e njohur në procesin e qeverisjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm në nivel lokal dhe kombëtar.

Projekti synon të kontribuojë për ndërtimin e një qytetarie (lëvizje komunitare) aktive, partnere e njohur në procesin e qeverisjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm në nivel lokal dhe kombëtar; të nxisë rrjetëzime kombëtare dhe lokale aktive të Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC-ve) për ruajtjen e natyrës dhe partneritetin e tyre në programe pune afatgjatë advokimi për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në nivel lokal, të rrisë angazhimin qytetar/komunitar dhe mediatik në aktivitetet advokuese të OShC-ve për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore lokale, duke përdorur të drejtën për informacion dhe pjesëmarrje mbi procesin e zbatimit të politikave dhe vendimmarrjes që ndikon në resurset natyrore lokale.

OShC-të shihen si forca lëvizëse për transformimin dhe për të zhvilluar e për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Megjithatë, për t'u përfshirë vërtet në hartimin e politikave të ruajtjes së natyrës, OShC-të duhet të rritin më tej kapacitetet dhe burimet e tyre.

Shkalla e ndërgjegjësimit mjedisor të publikut dhe të komunitetit të biznesit nuk është ende në nivelin e duhur. Roli i OShC-ve, edhe pse është rritur në mënyrë të ndjeshme, nuk ka ndikimin e duhur në jetën publike dhe politike të vendit. Gjithashtu, ngritja e strukturave qendrore e vendore për mbrojtjen e mjedisit përbën një arritje të rëndësishme, veçanërisht po të merret parasysh që trashëgimia institucionale dhe ligjore në këtë fushë ishte shumë e pakët. Domosdoshmëria e trajnimit të këtyre strukturave shtrohet sot në plan të parë.

Përmes analizës identifikohen dhe përshkruhet roli dhe rëndësia e palëve të përfshira, veçanërisht të OShC-ve dhe rrjetëzimeve të tyre lokale, në njohjen dhe kuptimin e kuadrit ligjor e rregullator të OShC-ve dhe aktorëve lokalë.

Kësisoj, kryerja e trajnimeve mbi legjislacionin kombëtar dhe luftën kundër korrupsionit, me fokus përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit, burimeve natyrore dhe mirëmenaxhimin e ZMM do të rrisë njohuritë e përgjithshme të OShC-ve, institucioneve dhe medieve për ruajtjen e natyrës, luftimin e korrupsionit, zvogëlimin e ndikimit negativ mbi pasuritë natyrore dhe ZMM, pjesëmarrjen publike në proceset vendimmarrëse si dhe do të ndërtojë kapacitetet e tyre për të advokuar dhe lobuar.

Ky dokument do të jetë një mjet për OShC-të për të organizuar lobimin e tyre tek autoritetet publike dhe një informim shtesë në njohjen dhe zbatimin e kornizave kombëtare të legjislacionit për përdorimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe të ZMM, të drejta e aksesit në informacion, drejtësia mjedisore, krimi mjedisor dhe të legjislacionit tjetër përkatës, në pajtueshmëri me kërkesat e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Dokumentin e shohim si një mjet të nevojshëm, për një dialog të vazhdueshëm, që do të ndihmojë të mësojmë, të kuptojmë dhe vijojmë të kapërcejmë sfidat e fushës së ruajtjes të natyrës, përmes mbështetjes së kornizës ligjore në bashkëpunim të ngushtë me institucionet qeveritare qendrore dhe lokale.

Dokumenti ndihmonë stafin dhe ekspertët e OShC-ve në angazhimin e tyre efektiv në përpjekjet kombëtare e lokale të ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit, u ofronë një mjet për rritjen e njohurive anëtarëve të tyre. OShC-të duhet të luajnë një rol aktiv dhe efektiv në planifikimin dhe zbatimin e masave të ruajtjes së natyrës dhe angazhimin e palëve të tjera të interesit për vendimmarrje koherente. Këto udhëzime synojnë të ndihmojnë OShC-të që të rrisin kuptimin e legjislacionit të BE-së për fushën e ruajtjes së natyrës dhe rolin që ata mund të luajnë në zbatimin e tij.


Analiza dhe projekti synon të risë dhe përmirësojë aftësitë e OShC-ve dhe rolin aktiv të tyre në analizimin, monitorimin dhe advokimin për zbatimin e ligjit dhe politikave, me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve natyrore, krahas fuqizimit të rolit të OShC-ve në luftën kundër korrupsionit, minimizimit të ndikimeve negative në keq menaxhimin e burimeve natyrore dhe ZMM; të inkurajojë bashkëpunimin midis OShC-ve dhe autoriteteve publike, komuniteteve lokale, medieve si dhe të inkurajojë krijimin e rrjeteve ose partneritetit midis tyre.

INCA mbështet krijimin dhe fuqizimin e rrjeteve përmes dhënies së informacionit, asitences teknike dhe në kuadër të zbatimit të nismës **“Njohja e legjislacionit kombëtar, të përgjegjësive dhe detyrime për zbatimin e tij në fushën e ruajtjes së burimeve natyrore”** me anëtarët e rrjetit lokal të OShC-ve, me përfaqësues të institucioneve vendore dhe aktorëve të tjerë lokal, gjithashtu, krahas njohjes e informimit, u siguruan mjetet e nevojshme për ndërtimit të metodologjisë monitoruese (Watch-dog) për vlerësimin e situatave, problematikat mjedisore, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, hartimin e strategjive advokuese, nxitjen e hartimit dhe zbatimit të planeve të veprimtimit lokal, ndërmarrja e aktiviteteve advokuese dhe pajtueshmërinë e transparencës të pjesëmarrjes publike në vendimarrjen e pushtetit vendor.

1. VËSHTRIM I SHKURTËR MBI KUADRIN LIGJOR MJEDISOR NË SHQIPËRI

Shqipëria ka legjislacionin e saj të ri mjedisor. Ky legjislacion bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shumica dërmuese e ligjeve të propozuara në Kuvend vijnë nga Qeveria. Ministritë zhvillojnë prioritetet e tyre legjislative të vitit të ardhshëm, që miratohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Hierarkia e normave ligjore konsiston në:



Edhe baza ligjore për mbrojtjen e natyrës buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (FIZ nr. 28/1998).

Neni 59, i Kushtetutës thekson se: “Shteti synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, dhe *shfrytëzimin racional të burimeve natyrore* mbi bazën e *parimit të zhvillimit të qëndrueshëm*”, dhe ka për qëllim të sigurojë:

a) Një *mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të qëndrueshëm* për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

b) Shfrytëzimin racional *të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore* mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni 56, i Kushtetutës thekson se: “Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij”. Dispozitat kushtetuese theksojnë se:

- *Mjedisi dhe mbrojtja e tij, konsiderohen si qëllimet themelore të shtetit;*

- Thelbi i mbrojtjes së mjedisit *është ruajtja e vazhdueshme e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm;*

- Mbrojtja e mjedisit *është një detyrë e përhershme në çdo kohë dhe në çdo rrethanë* dhe ka lidhje direkte me jetën dhe shëndetin e popullatës;

- *Zhvillimi i qëndrueshëm është një kërkesë themelore* dhe në këtë mënyrë Kushtetuta garanton mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

- Publiku ka të *drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit* dhe institucionet shtetërore janë të detyruara të informojnë publikun në lidhje me mjedisin dhe masat e marra për mbrojtjen e tij.

Në Kushtetutë sanksionohet e **drejta e qytetarëve për të marrë informacion mbi gjendjen e mjedisit** dhe për mbrojtjen e tij nga institucionet shtetërore. **Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore** u mundëson qytetarëve të shprehen dhe vendimmarrësve të konsiderojnë opinionet dhe shqetësimet të cilat janë të rëndësishme për vendimmarrjen. Kjo e drejtë rrit cilësinë, përgjegjshmërinë dhe transparencën e procesit të vendimmarrjes dhe

kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit publik në çështjet mjedisore.

Kodi Civil në një kapitull të veçantë "Detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit", parashikon: Personi i cili, gabimisht, *ka rrezikuar mjedisin, e ka përkeqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, plotësisht ose pjesërisht, është i detyruar të kompensojë dëmin e shkaktuar.*


Kohët e fundit ndryshimet e fundit në Kodin Penal mundësuan integrimin e një kapitulli të ri specifik për *krimet kundër mjedisit*. Megjithëse nuk është një kapitull shumë i përfunduar, ai është një rrugë përpara për fillimin e një procesi të ri me sanksione dhe dënime ndërsa kryhen krime kundër mjedisit. Në këtë kapitull *ndotja e ajrit, e ujërave i pyjeve dhe e tokës, menaxhimi i mbetjeve, dëmtimi dhe tregtimi i specieve të mbrojtura të florës e faunës së egër, dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore, peshkimi i paligjshëm,* etj. janë tani pjesë e këtij kapitulli.

Në përgjithsi legjislacionit mjedisor në Shqipëri, është frymëzuar dukshëm nga standartet e BE-së, ku parimet kryesore mbi mjedisin janë përfshirë, në legjislacionin shqiptar.

Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 "**Për mbrojtjen e mjedisit**" hodhi themelet për një legjislacion mjedisor bashkëkohor. Në krahasim me ligjin "Mbrojtja e mjedisit" (1993), plotësohen kërkesat kushtetuese për të drejtën e qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm, përdorimit racional të pasurisë natyrore, parandalimi dhe kontrolli i ndotjes.

Me krijimin e Ministrisë së Mjedisit (2001), si një institucion qendror i dedikuar për mbrojtjen e mjedisit, aspekti institucional i organeve mjedisore mori dimensione të reja.

Parimet ndërkombëtare *të ruajtjes së burimeve natyrore* mungonin në legjislacionin e vendit, para viteve 2000. Mbrojtja e natyrës dhe parimet e përgjithshme, garantohen edhe nëpërmjet ligjit "Për mbrojtjen e mjedisit", ku është përcaktuar se "*ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike*" është një prej elementeve të mjedisit. Mbrojtja e biodiversitetit mund të arrihet vetëm duke



pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në sektorë që lidhen me biodiversitetin, të tilla si: bujqësia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi. Korniza ligjore për mbrojtjen e natyrës përbëhet nga të gjitha nivelet dhe tipet e ligjeve dhe akteve normative.

Ky legjislacion është përgjithësisht i përqsuar me standartet e BE-së dhe ndërkombëtar, sepse mbështetet në të njëjtat parime që është mbështetur legjislacioni mjedisor evropian, është hartuar me asistencën e ekspertëve të huaj, dhe pasqyron përgjithësisht kërkesat e konventave, në të cilat Shqipëria është palë.

Megjithatë, legjislacioni mjedisor vazhdon të jetë në një proces plotësimesh e përmirësimesh,

për t'iu përgjigjur me efektivitet nevojave për politika bashkëkohore të mbrojtjes mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm dhe procesit drejt integritit në BE.

Masat për **mbrojtjen e natyrës, biodiversitetit, ZMM dhe peizazhet** duhet të jenë pjesë e rëndësishme e politikave qendrore, rajonale e lokale të zhvillimit, me qëllim që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm, bazuar në një marrëdhënie të balancuar e në harmoni midis nevojave sociale, veprimtarive ekonomike dhe mjedisit dhe trashëgimisë natyrore.

Ka disa akte ligjore që garantojnë mbrojtjen e natyrës dhe të burimeve natyrore në RSh, nga të cilat, më kryesoret, përshkruhen më poshtë. Për të siguruar zbatimin e këtyre ligjeve, janë hartuar një numër aktesh nënligjore për të plotësuar bazën ligjore për elementet specifike të mbrojtjes së natyrës.

Megjithë përpjekjet e bërë në kornizën ligjore, në aspektin e mbrojtjes së natyrës dhe shumëllojshmërisë biologjike e peizazhore, duhet të pranojmë, se ka ende boshllëqe në plotësimin dhe zbatimin e tyre. Kjo situatë ka krijuar konfuzion edhe në lidhje me vendosjen e përgjegjësive dhe kompetencave përkatëse.

OShC-të dhe rrjetëzimet e tyre lokale apo/dhe kombëtar duhet të kuptojnë, zbatojnë dhe të kërkojnë që e drejta mjedisore është tërësia e normave ligjore që rregullon marrëdhënien e njeriut me mjedisin. Kësaj marrëdhënie po i jepet çdo herë e më tepër rëndësi me synimin e një mjedisi të shëndetshëm.

Si një e drejtë themelore, e drejta e qytetarëve për t'iu informuar mbi gjendjen e mjedisit dhe detyrimi për mbrojtjen e tij garantohen drejt për së drejti nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si akti ligjor më i lartë në hierarkinë e normave.

Të drejtat mjedisore përfshihen në kategorinë e të drejtave ku institucionet shtetërore kanë detyrimin të veprojnë për të garantuar një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Autoritetet publike (qendrore e lokale) marrin shpesh vendime që mund të kenë efekte të rëndësishme në mjedis si dhe në shëndetin publik dhe mirëqenien e qytetarëve, prandaj duhet të kenë gjithmonë në konsideratë detyrimin kushtetues për një mjedis të shëndetshëm.

2. LEGJISLACIONI PËR RUAJTJEN E MJEDISIT DHE NATYRËS NË PAJTIM ME KËRKESAT E BE-së

2.1 Ligj nr. 10431, datë 09.06.2011''Për mbrojtjen e mjedisit''.

(Fl.Z. nr.89/2011), ndryshuar me ligjin nr. 31, datë 14.02.2013 (Fl.Z. nr.30/2013).

Qëllimi i ligjit është mbrojtja, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Gjithashtu, përcaktohen parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për *garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit* në RSh. Objektivat janë: a.*parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve* të tjera të çdo lloji; b.*ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit*; c.*ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike*; ç) *përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj*; d.*ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror*; dh) *mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit*; e.*mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut*.

Parimet e mbrojtjes së mjedisit: **Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm**; Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake; **Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore**; Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit; Parimi i qasjes së integruar; Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit; **Parimi "Ndotësi paguan"**; **Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut**; **Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit**.

Mbrojtja e përbërësve të mjedisit fokusohet tek: **Mbrojtja e integruar, e Ajrit, e Ujërave, e Tokës, e Natyrës**, ku përfshihen masat për *mbrojtjen e pyjeve natyrore, pjesërisht natyrore, komplekseve pyjore dhe të tokës pyjore, rrjedhave dhe burimeve ujore, florës dhe faunës në një rajon pyjor*, si dhe të stacioneve të gjeneve dhe farërave të varieteteve vendase të drurëve si dhe masat përkatëse për *zbatimin e mbrojtjes së natyrës dhe të pyjeve* përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm dhe **Ndryshimet klimatike**.

Mbrojtja e mjedisit përfshihet: Procesi i planifikimit, **strategjia dhe plane mjedisore kombëtare**, të cilët miratohen me VKM. **Autoritetet e qeverisjes vendore** përgatitin **plane veprimi vendore, për mjedisin**, të cilët rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt.

Për parandalimin e efekteve negative, projektet e zhvillimit i nënshtrohen VNM, duke **përcaktuar efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror**, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

Veprimtaritë që mund të kenë ndikim në mjedis, duhet të **pajisen me lejen përkatëse të mjedisit**, ku përcaktohen kushtet e nevojshme për të garantuar se veprimtaria/instalimi do të përmbushë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.

Parandalimi dhe reduktimi i **efekteve negative në mjedis** bëhet **në kuadër të menaxhimit të integruar të mbetjeve**. Mbrojtja nga efektet e dëmshme që vijnë prej kimikateve, për

përdorimin e substancave ozon holluese, për pesticidet; zhurmat dhe erërat e pakëndshme si dhe për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht (OMGj).

Monitorimi i gjendjes së mjedisit përfshin: *a.cilësinë e ujërave sipërfaqësore; b.cilësinë e ujërave nëntokësore; c.cilësinë e ajrit; ç.mbetjet; d. zhurmat; dh.rrezatimet; e.cilësinë e tokës;ë.florën, faunën, biodiversitetin, pyjet;* f. ndikimet e sektorëve ekonomikë mbi përbërësit e mjedisit; g. *monitorimin e fenomeneve natyrore* dhe ndikimin e mundshëm të tyre mbi mjedisin; gj.monitorimin e ndikimeve të ndotjes së mjedisit mbi shëndetin e njeriut.

Ligji i ka dhënë një rëndësi të madhe të **drejtës për informim**, duke e ndarë në dy momente: E drejta e publikut për të **kërkuar informacion mjedisor** dhe detyrimi i autoriteteve për ta **dhënë këtë informacion** në kohë, përfshirë çdo informacion mbi përbërësit e mjedisit.

Ashtu sikurse të gjithë kanë të drejtë për një mjedis të shëndetshëm, secili **mban përgjegjësi për veprimet në dëm të mjedisit**, mbështetur në parimin “**Ndotësi paguan**” me qëllim parandalimi dhe zhdëmtimi i të gjithë dëmit që i shkaktohet mjedisit; rehabilitimi i mjedisit dhe prezantimi i masave dhe i praktikave për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të mjedisit.

Subjektet fizike apo juridike dhe OShC-t, kanë të drejtë t’i kërkojnë AKM që operatori të kryej rikthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar në mjedis.

Organizata dhe grupe, grupe operatorësh ose operatorë individualë, mund të lidhin marrëveshje vullnetare me autoritetet përkatëse, që të realizojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përbërës mjedisor.

Ministritë përgjegjëse për arsimin, për çështjet e punësimit dhe për formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë për mjedisin, **nxitin, mbështetin dhe organizojnë edukimin dhe trajnimin për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm**, përmes sistemit arsimor, kërkimit shkencor, formave të të mësuarit, të të formuarit dhe të trajnimit gjatë gjithë jetës.

Inspektimi kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ka për detyrë të ndërmarrë çdo veprim, që mund të jetë i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit si dhe me kërkesat e përcaktuara në dispozitat e legjislacionit specifik.

2.2 Ligj nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

(Fl.Z. nr.101/2011), ndryshuar me ligjin nr.12, datë 26.02.2015.(Fl.Z. nr.38/2015) dhe ligjin nr.128/20202.

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i **kërkesave, përgjegjësive, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin** e RSh, të projekteve të propozuara, private apo publike.

Ky ligj zbatohet për **projektet e propozuara, private apo publike**, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejt ose jo, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre.

Ligj përcakton **parimet e përgjithshme të vlerësimit të efekteve mjedisore të projekteve publike dhe private që ka të ngjarë të kenë efekte të rëndësishme në mjedis.**

Gjithashtu, përcaktohen **kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve negative në mjedis**, për të gjitha projektet e propozuara private ose publike, të cilët ka të ngjarë të prodhojnë efekte negative në mjedis.

Dispozitat parashikojnë detyrimin për të zhvilluar procedurat e VNM në lidhje me raste të jashtëzakonshme dhe me projektet për qëllime të mbrojtjes kombëtare. Thënë kjo detyrimi i direktivës, për të përcaktuar nëse projektet e Aneksit II do të paraqiten në **VNM të thellë.**

Ligji përshkruan në **një aneks të gjitha aktivitetet specifike** që duhet t'i nënshtrohen VNM-së së thellë (Shtojca I) dhe kërkon **përfshirjen e të gjitha palëve** në procesin e VNM, **publikun dhe OJF-të pa ndonjë kualifikim specifik.**

AKM ka detyrë të zhvillojë për çdo projekt një seancë **dëgjimore me publikun dhe OJF-të e interesuara** në mënyrë që të përfshinte mendimin e tyre në vendimmarrjen përfundimtare.

Dëgjesat duhet të **kryhen në bashkëpunim me autoritetet përkatëse lokale** dhe zhvilluesit e projekteve. **Autoritetet lokale**, si dhe zhvilluesit/propozuesit duhet të **njoftojnë publikun dhe OJF-të e interesuara** për datën, kohën dhe vendin e seancës.

Mendimet dhe komentet e shprehura nga publiku dhe OJF-të janë një kriter i detyrueshëm në vendimmarrjen e VNM-së.

Ligji përshkruan **rolet dhe funksionet e të gjithë aktorëve** si **AKM/ARM, njësitë e qeverisjes vendore dhe propozuesit** në proceset e mësipërme.

Vërehet se në mjaft raste **procesi i informimit publik nuk është bërë siç duhet.** Ka shumë kushte dhe kërkesa që kategorizojnë procesin siç bëhet në përputhje me Direktivën e VNM dhe Konventën e Aarhus.

Një çështje problematike ka qenë procesi i **VNM për kontratat koncesionare.** Zakonisht këto kontrata kanë përfitime të mëdha ekonomike për shtetin, duke përfituar edhe nga ndjeshmëria e lartë politike, procesi i konsultimit publik nuk realizohet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore.

Një hap i mirë është përfshirja e publikut në **hartimin e planeve dhe programeve** një qasje e pranuar nga **autoritetet publike**, të cilët **ftojnë OJF-të për konsultime dhe diskutime për projekt strategjitë, ose projektligjeve, grupeve të punës ose takimeve të tjera.**

Është vërejtur se ndonjëherë pjesa **më e madhe e OJF-ve** nuk janë të pranishme, për shkak se ata ende mendojnë se ky nuk është një proces i vërtetë i konsultimit publik. Për t'u përmendur është fakti se në nivel **të autoriteteve lokale përfshirja e OJF-ve gjatë** proceseve të Planifikimit (VSM) dhe projekte të tjera të rëndësishme të ndërtimit, zakonisht **organizojnë takime të vogla konsultative.** Në nivel **bashkiak, bashkëpunimi me OJF-të** kryesisht përqendrohet në veprime dhe projekte konkrete, ndërgjegjësimi mjedisor.

2.3 Ligj nr. 91, datë 28.02.2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”

(Fl.Z. nr.36, datë 19 Mars 2013)

Qëllimi i ligjit është të sigurojë **mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm**, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis.

Përcakton institucionet dhe të **drejtat e përgjegjësitë e tyre**, si dhe procedurat, sipas të cilave kryhet VSM, për hartimin apo ndryshimin, rishikimin ose modifikimin e **planeve a programeve sektoriale** që sigurojnë integrimin e **parimeve të mbrojtjes së mjedisit** që në fazën e hartimit të këtyre dokumenteve.

Procesi i VSM kalon detyrimisht në këto faza: a) **njoftimi i ministrisë** nga autoriteti propozues; b) **konsultimi me grupet e interesit** për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së; c) **hartimi i raportit paraprak e konsultimi me grupet e interesit dhe publikun** i raportit paraprak të VSM-së; ç) **hartimi i raportit përfundimtar** të VSM; d) shqyrtimi i propozimit dhe **deklarata e ministrit**; dh) **vendimi** i autoritetit miratues; e) **monitorimi dhe raportimi** i pasojave në mjedis të planit apo programit.

Ministria, përdor edhe kriteret ndihmëse të shtojcës I të ligjit, për të përcaktuar çështjet, që kërkon të përfshihen në raportin e VSM-së, si dhe për të vendosur për nevojën e VSM-së për rishikimin, ndryshimin apo modifikimin e një plani ose programi ekzistues dhe e dërgon për mendim propozimin për ndryshimin ose modifikimin e planit apo programit te grupet e interesit.

Grupet e interesit i përgjigjen ministrisë brenda 20 ditëve nga marrja e kërkesës për dhënien e mendimit të tyre, për nevojën ose jo të VSM-së për rishikimin, ndryshimin apo modifikimin e planit ose programit të propozuar dhe, nëse ato nuk shprehen brenda afatit ligjor, nënkuptohet se nuk kanë kërkesa për propozimin. Në rast se ministria vendos se rishikimi, ndryshimi apo modifikimi i planit ose programit ekzistues duhet t’i nënshtrohet VSM-së, atëherë atij i bashkëlidhen edhe sqarimet e kërkesat.

Ndaj qëndrimit të ministrisë, mund të bëhet ankim, sipas parashikimeve të ligjit.

Autoriteti propozues, përpara fillimit të hartimit të raportit të VSM-së, konsultohet edhe me këto **grupe interesi, përgjegjësia e të cilave lidhet me planin apo programin**, dhe u kërkon të paraqesin sugjerimet e tyre për çështjet që duan të trajtohen në këtë raport: a) **institucionet e mbrojtjes së shëndetit publik**; b) **njësitë e qeverisjes vendore**; c) **institucionet e mbrojtjes së tokës bujqësore**; ç) **shoqatat mjedisore (OJF) aktive në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi**; d) **institucionet e tjera** që identifikohen me përgjegjësi në propozim (ministritë etj.).

Hartimi i raportit të VSM-së është përgjegjësi e **autoritetit propozues** dhe përgatitet nga subjekte fizike ose juridike të certifikuara nga ministria e të licencuara.

Autoriteti propozues, pasi të ketë hartuar **raportin paraprak** të VSM-së, realizon konsultimin me publikun dhe **grupet e interesit, përfshirë dhe OJF-të**, për rezultatet paraprake të raportit.

Zhvillimi i konsultimit me grupet e interesit dhe publikun, të raportit paraprak të VSM-së, **është kusht i domosdoshëm** që ministria të marrë në shqyrtim dhe të miratojë deklaratën.

Raporti përfundimtar i VSM-së përgatitet dhe paraqitet si dokument i veçantë nga dokumenti i planit ose i programit të propozuar, trajton edhe rezultatet e konsultimeve të raportit paraprak të VSM-së **me grupet e interesit, publikun** dhe shtetin fqinj, në rast të një procesi ndërkufitar konsultimesh.

Deklarata e ministrit është qëndrimi zyrtar i ministrisë dhe kusht i domosdoshëm për marrjen në shqyrtim për miratim të planit apo programit nga autoriteti miratues.

Deklarata e ministrit përmban: a) qëndrimin e ministrisë lidhur me propozimin; b) përputhjen e planit apo programit të propozuar me **objektivat e mbrojtjes së mjedisit**, përcaktuar në dokumentet e politikës mjedisore, dhe legjislacionin mjedisor; c) arsyetimin se si janë marrë në konsideratë **mendimet e publikut** për pasojat në mjedis të planit apo programit; ç) sugjerimet e dhëna nga shteti i prekur dhe mënyrën sesi janë konsideruar në deklaratën e ministrit, në rast të zbatimit të nenit 17; d) ndikimet e **mundshme në mjedis** të planit apo programit të propozuar; dh) **masat zbutëse** që duhet të merren për **mbrojtjen e mjedisit**; e) kërkesat për **monitorimin mjedisor** gjatë zbatimit të planit dhe programit; ë) kërkesat për raportimin periodik në ministri të autoritetit propozues gjatë fazave të zbatimit të planit dhe programit.

Grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, mund të ankimojnë në rrugë administrative, siç parashikohet në Kodin e Procedurave Administrative.

Autoriteti propozues që zbaton ose mbikëqyr zbatimin e planit apo programit harton një raport vjetor për masat e marra **për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit**, i cili i dërgohet ministrisë.

Kur ministria merr informacion apo njoftim nga një shtet tjetër në lidhje me një plan ose program të propozuar, fillon menjëherë bisedimet me palën e origjinës, në përputhje me kërkesat e konventës së Kombeve të Bashkuara “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar (ESPOO)” dhe protokollit të saj “Për vlerësimin strategjik mjedisor (KIEV)”, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

2.4 Ligj nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.

(Fl.Z.nr.84/206), ndryshuar me ligjin nr.37, datë 14.02.2013 (Fl.Z.nr.30/2013) dhe ligji nr.68, datë 03.07.2014 (Fl.Z nr.115/2014)

Konsiderohet ligji bazë për ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në Shqipëri. Ka për qëllim të sigurojë **mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik** si dhe të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Dipozitat e ligjit përfshijnë: a) të gjitha sipërfaqet gjeografike, tokësore, ujore dhe detare të RSh, pronë shtetërore apo private; b) të gjithë përbërësit e diversitetit biologjik; c) organet shtetërore, që veprojnë në kuadër të këtij ligji apo të ligjeve të tjera të kësaj fushe, nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, vendas dhe të huaj, veprimtaritë e të cilëve

kanë ndikim në biodiversitet, si dhe nga organizatat shoqërore dhe nga publiku.

Në instrumentet e planifikimit të biodiversitetit, kërkohet të hartohet: “**Strategjia dhe plani i veprimit të biodiversitetit**”, për një periudhë 10-vjeçare. Për ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij ngrihet **Rrjeti i inventarizimit dhe i monitorimit të biodiversitetit**, si burim kryesor informacioni për të mbështetur vendimmarrjet në të gjitha nivelet. Miratohet çdo 5 vjet, me urdhër të ministrit përgjegjës “**Lista e kuqe e florës dhe faunës së egër**”.

Për të **ruajtur ekosistemet, habitatet dhe peizazhet**, kur ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të ZM, pronë publike apo private, përcaktohen masat duke identifikuar kategoritë e ekosistemeve, habitateve dhe peizazheve, përfshijnë ligatinat dhe zonat e tjera me ndjeshmëri të lartë mjedisore, që identifikohen për të marrë një status të përshtatshëm ruajtjeje.

MTM dhe MB, në bashkëpunim me **organe të tjera shtetërore dhe vendore, me OShC-t, persona juridikë dhe fizikë, hartojnë planet e menaxhimit, për të mbajtur apo rivendosur statusin e favorshëm të ruajtjes së ekosistemeve, habitateve a peizazheve të mbrojtura, veçanërisht të mbrojtura dhe me interes për komunitetin.**

Veprimtaritë që përdorin dhe shfrytëzojnë elemente të diversitetit biologjik dhe të përbërësve të tij duhet të **pajisen me leje mjedisore.**

Këshilli i Ministrave, miraton: a) listën e llojeve të habitateve natyrore me interes për komunitetin, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes; b) listën e llojeve të bimëve dhe kafshëve me interes për komunitetin, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes; c) listën e llojeve të bimëve dhe kafshëve me interes për komunitetin nënevojë për mbrojtje strikte; ç) listën e llojeve të bimëve dhe kafshëve me interes për komunitetin, marrja e të cilave në gjendje të egër dhe shfrytëzimi mund të jetë objekt i masave menaxhuese; d) parimet e identifikimit të llojeve që do të jenë objekt kërkimesh për mbrojtjen dhe menaxhimin e shpendëve të egër.

Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i llojeve tokësore, ujore e detare dhe habitateve të tyre kushtëzohet nga mbajtja apo rivendosja e statusit të favorshëm të ruajtjes për llojin në habitatin e vet.

Shfrytëzime apo përdorime të reja të individëve të llojeve të kafshëve dhe bimëve të mbrojtura lejohen të ushtrohen kur nuk **cenojnë statusin e ruajtjes së llojeve të kërcënuara**, dhe kur janë pajisur me leje mjedisore. si dhe për: a) qëllime shkencore apo edukimi; b) ruajtje ex-situ, për masa përzgjedhëse ose qëllime riintroduktimi; c) materiale gjenetike; ç) të mbrojtur diversitetin biologjik; d) shëndetin, sigurinë dhe qëllime turistike; dh) masa sanitare apo fitosanitare.

Për llojet veçanërisht të mbrojtura, të regjistruara me status ruajtjeje të pafavorshëm, ministria, në bashkëpunim me organet shtetërore, qendrore e vendore, institute të specializuara, **organizata jofitimprurëse** dhe me persona fizikë e juridikë, **harton planet e veprimit për ruajtjen e llojit** dhe përfshihen në strategjitë, planet, programet dhe në vendimmarrjet shtetërore, në nivel kombëtar dhe vendor.

Importimi dhe/ose introduktimi i qëllimshëm i llojeve të huaja ose i llojeve të huaja invazive

në mjediset tokësore, ujore ose detare të RSh bëhet vetëm pas **vlerësimit të ndikimit në mjedis**. Këshilli i Ministrave, miraton listën e llojeve të huaja ose llojeve të huaja invazive dhe përcakton procedurat për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit.

Ruatje “ex-situ” janë masat menaxhuese, të nevojshme për ruajtjen e llojeve dhe të burimeve të tyre gjenetike shoqëruese, jashtë ekosistemeve apo habitateve të tyre natyrore. Për racat e varietetet autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, kuptohet ruajtja jashtë mjediseve të prodhimit, ku ato kanë zhvilluar karakteristikat e tyre dalluese.

Ruatje “in-situ” janë masat menaxhuese, të nevojshme për të ruajtur ekosistemet dhe habitatet e për të mirëmbajtur ose për të restauruar popullatat e llojeve, që mund të jetojnë në habitatet e tyre. Për racat dhe varietetet autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, kuptohet ruajtja brenda mjediseve të prodhimit, ku ato kanë zhvilluar karakteristikat e tyre dalluese.

Me Akses nënkuptohet lejimi, përvetësimi dhe ndarjen e burimeve gjenetike ose të njohurive tradicionale të lidhura me to.

Organet shtetërore kanë detyrimin të informojnë publikun për diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij me **qëllim që publiku të kontribuoj në ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm** si dhe të **përfshihet në vendimmarrje**.

Çdo organ shtetëror, **organizatë shoqërore**, person juridik ose fizik, që dëmton ose kërcënon biodiversitetin, përgjigjet për dëmtimet dhe përballon koston e ripërtëritjes e të rehabilitimit.

Organet shtetërore **sigurojnë që publiku dhe shoqëria civile**: a) të vihen në dijeni gjerësisht për diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij nëpërmjet botimit të të dhënave dhe programeve të ndërgjegjësimit e të edukimit; b) të përfshihen në vendimmarrje për diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij, që përfshin edhe proceset e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të vlerësimit strategjik mjedisor; c) t’u sigurohet e drejta për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet që lidhen me ruajtjen e diversitetit biologjik dhe përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij.

Politikat, programet, regjistrat dhe vendimmarrjet realizohen në këshillim me organet e tjera shtetërore, **me organizatat jofitimprurëse dhe me publikun**. Mendimet e tyre vlerësohen nga vendimmarrësit përpara marrjes së vendimeve dhe sigurojnë se dokumentet dhe instrumentet, që lidhen me biodiversitetin, të përcaktuara në këtë ligj apo në ligje të tjera, të jenë të disponueshme për publikun.

2.5 Ligj nr.81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”

(Fl.Z. nr.166/2017).

Është ligji **bazë i Sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore (SZMM)** në Shqipëri. Ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të ZM dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe **përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve publike dhe personave fizik/juridik privat** për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të ZM.

Menaxhimi e ruajtja e ZMM realizohet nëpërmjet parimeve: a) Parimi i zhvillimit të

qëndrueshëm; b) Parimi i integritetit; c) Parimi “ndotësi paguan”; ç) Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake.

Tërësia e ZMM përbën sistemin kombëtar të territoreve të mbrojtura, të shpallura me anë të legjislacionit, në mbështetje në kriteret e Unionit Ndërkombëtar të Ruajtjes së Natyrës (IUCN).

ZMM, që ka marrë statusin e mbrojtjes, janë: a) zona të mbrojtura me interes kombëtar; b) zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar, ku bëjnë pjesë: i) zonat “Ramsar”; ii) zonat me interes për Komunitetin Evropian (SACs) - zonat e veçanta të ruajtjes të habitateve dhe të shpendëve (SCI dhe SPAs); iii) zonat me interes të veçantë ruajtjeje (zonat e rrjetit Emerald); iv) zonat “Rezervë të biosferës”; v) zonat e trashëgimisë natyrore.

ZMM janë pasuri kombëtare me pronësi: a) shtetërore; b) private. Ndërsa forma e administrimit/menaxhimit është: a) shtetërore; b) private; c) bashkiake; ç) të kombinuara. Forma e administrimit/menaxhimit përcaktohet me VKM.

Territoret dhe objektet private, të përfshira në ZMM, mbeten në pronësi private, por administrohen e përdoren prej pronarit/ve/bashkëpronarëve ose prej përdoruesit të ligjshëm, sipas kërkesave të Planit të Menaxhimit (PIM).

Shpallja e Zonave të Mbrojtura përcakton: - Identifikimi dhe administrimi i ZM bëhen në përputhje me Planin Specifik të ZM dhe dokumente të tjera strategjike të fushës së mbrojtjes së natyrës; - ZMM shpallen me VKM, ku përcaktohen emërtimi, kategoria, sipërfaqja, institucioni menaxhues, objektivat e ruajtjes së zonës dhe shkalla e mbrojtjes së nënzonave; - Shpallja e një ZMM bëhet pas marrjes së mendimit të institucioneve akademike e shkencore në vend, **të bashkisë, të shoqërisë civile** dhe ekspertë të fushës, të **komunitetit të zonës** dhe të pronarëve privatë, pronat e të cilëve do të përfshihen në ZMM.

Propozimi për shpallje përfshinë: a) argumentimi për krijimin e ZMM që mbështet objektivat e PKZM, epërsitë dhe mangësitë e krijimit të zonës, zonimin e saj, si dhe shkallët e mbrojtjes, për secilën zonë; b) rezultatet e **procesit të këshillimit me komunitetin lokal e shoqërinë civile**, veçanërisht miratimin me shkrim nga bashkia; c) një hartë e formatit GIS; ç) një VNM; d) një vëzhgim i ndikimit social dhe ekonomik të popullatës vendore; dh) një përshkrim i masave kompensuese; e) miratimi i KKT mbi kufirin e ZMM dhe zonimin.

Heqja ose ndryshimi i statusit të një ZMM bëhet me VKM. Propozimi për ndryshimin e sipërfaqes së zonës **konsultohet paraprakisht me komunitetin vendas**, me pronarët, me subjektet që ushtrojnë veprimtari brenda zonës, me **institucionet shkencore**, me **organet e qeverisjes vendore** dhe argumenton nevojën e ndryshimit.

Çdo organ e **institucion shtetëror, qendror ose vendor, person juridik ose fizik, OJF ose komunitet**, ka të drejtë të paraqesë pranë ministrisë propozime për shpalljen, për ndryshimin ose heqjen e statusit të çdo ZM, zgjerimin ose zvogëlimin e kufijve dhe zonimin.

Territori i ZMM ndahet në nënzona, veçanërisht të kategorive **“Park kombëtar”, “Rezervë natyrore e menaxhuar” dhe “Peizazh i mbrojtur”**, ndërsa për kategoritë **“Rezervë strikte e mbrojtur”** dhe **“Monumentet e natyrës”** ka zonë buferike.

Zonimi mund të përmbajë: (1) zonën qendrore, (2) zonën e përdorimit tradicional dhe

zhvillimit të qëndrueshëm (3) zonën e rekreacionit.

Kategoritë e ZMM përfshijnë: **“Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor”**(kategoria I/RSN), ku zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes; **“Park kombëtar”** (kategoria II/PK), ku zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës, që rregullojnë përdorimin e qëndrueshëm nga ana e njeriut të burimeve natyrore; **“Monument natyror”** (kategoria III/MN), zbatohet shkalla e mbrojtjes, si “Rezervë strikte”, dhe rrethohen nga zona buferike; **“Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror”** (kategoria IV/RNM/P), ku garantohet ruajtja e habitateve dhe të plotësohen kërkesat specifike të llojeve me rëndësi rajonale e vendore; **“Peizazh i mbrojtur”** (kategoria V/PM), për mbrojtjen e vlerave peizazhistike të zonës, diversiteti biologjik, si dhe për çlodhje e argëtim; **“Zona të mbrojtura mjedisore të burimeve të menaxhuara”** (kategoria VI/ZMMBM), përmbajnë kryesisht sisteme natyrore, ku mbarështimi siguronë mbrojtje afatgjatë; **“Zonë e mbrojtur detare”** (ZMD), shpallet çdo sipërfaqe detare, bregdetare e nënujore, shtrati i detit dhe ishujt, së bashku me florën, faunën, habitatet e peizazhin dhe karakteristikat historike, kulturore e arkeologjike; **“Kurorë e gjelbër”** (kategoria V/(KGje), shpallet me vendim të KKT, me qëllim mbrojtjen e kurorave të gjelbra të çdo bashkie, që i përshtaten karakterit dhe që lidhen ekskluzivisht me nevojat e komunitetit; **“Park natyror bashkiak** (kategoria IV)/(PNB), shpallet me Vendim të Këshillit Bashkiak (VKB), dhe sigurojnë përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillimin e veprimtarive, që lidhen ekskluzivisht me nevojat e komunitetit; **“Zona e mbrojtur ndërkuftare”**, është pjesa e tokës dhe/apo ajo ujore, e shtrirë në më shumë se një shtet, që integrohet në menaxhimin e përbashkët; **Zonë veçanërisht e mbrojtur si habitat i llojeve të shpendëve ujorë (zonat “Ramsar”) dhe “Zonat e rëndësishme për zogjtë” (IBA); “Rezerva të biosferës”;** **“Zona të veçanta ruajtjeje”**, shpallen zonat ku strehohen tipat e habitateve natyrore me interes për komunitetin evropian dhe të habitateve të llojeve me interes për këtë komunitet.

“Rrjeti ekologjik” ka objektiv mbajtjen ose rivendosjen e një statusi të favorshëm ruajtjeje për ekosistemet, habitatet dhe peizazhet dhe konsiston në **“Zonat e Rëndësisë së Veçantë”**, sipas direktivës së habitateve dhe **“Zonat e Mbrojtjes”**, sipas direktivës së shpendëve.

Ministria, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, **me bashkitë, me publikun e interesuar, shoqërinë civile dhe me pronarët privatë**, miraton PIM për secilën ZMM, të hartuar nga AKZM-ja. PIMZM janë 10-vjeçare.

ZMM regjistrohen në portalin dhe Bazën e të Dhënave Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, dhe monitorimi i veprimtarisë së ZMM ushtrohet nga AdRZM dhe nga subjektet e angazhuara prej saj.

Ministria mbështet dhe promovon **programet kërkimore kombëtare** për ZMM. AdZM-të, në bashkëpunim me **shoqërinë civile, me shkollat në afërsi të ZM dhe me bashkitë organizon trajnime dhe fushata sensibilizimi me komunitetet lokale, me nxënësit dhe me subjektet që ushtrojnë veprimtari në ZMM.**

Në ZMM mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore dhe çdo lloj veprimtarie tjetër e parashikuar në PIM.

Veprimtaritë lejohen të ushtrohen në ZMM pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të

organit, të jetë marrë më **parë leja e mjedisit**. Në ZM detare e bregdetare është i **ndaluar peshkimi për qëllime tregtimi**, referuar dispozitave të legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën.

Pyjet në ZMM përjashtohen nga klasifikimi si **pyje prodhuese** dhe gjuetia është e ndaluar në të gjitha kategoritë e ZMM.

Ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin kryhen nga **banorët** e ZM, me **qëllim përballimin e nevojave të tyre për ngrohje**, në bazë të miratimit nga AdZM-ja të projektit teknik dhe të listës emërore të banorëve të zonës, të konfirmuar nga administratori i **njesisë së qeverisjes vendore**.

Menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera, **pronë publike dhe private**, bëhen nga AdZM dhe në përputhje me PIMZM. Edhe kur këto pasuri janë pronë private, menaxhohen e përdoren nga pronari ose përdoruesi i ligjshëm vetëm në përputhje me PIMZM.

AKZM-ja është përgjegjëse për administrimin e të gjitha të ardhurave të realizuara nga aktiviteti ekonomik në territorin e ZMM, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi.

Të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, masa dhe kriteret e përdorimit të tyre përcaktohen me VKM si dhe krijohet “Fondi i Veçantë për Zonat e Mbrojtura” (FVZM).

Ministria përgjegjëse është institucioni qendror politikëbërës për mbrojtjen dhe administrimin e ZM, ka të drejtë propozimin e shpalljes, ndryshimit dhe heqjes së ZM, miratimin e hartimin e PIM të tyre, zonimin, rritjen e sipërfaqes, rishikimin e statusit të ZM.

AKZM, është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për ZM, në nivel qendror. AdRZM, janë institucione, në varësi të AKZM-së, në çdo qark dhe përbëjnë rrjetin institucional vendor të specializuar, që zbatojnë detyrat për mbrojtjen dhe zhvillimin e ZMM që ndodhen në qark.

Bashkitë zbatojnë kërkesat e ligjit nr.81/2017 dhe të **ligjeve të tyre organike**, në lidhje me ZM dhe bashkëpunojnë me AKZM dhe AdZM përkatëse.

Komitetet e Menaxhimit (KoM) krijohet për të ndjekur zbatimin e PIMZM ngrihen me përbërje nga bashkia/bashkitë, brenda territorit administrativ të të cilit/cilave ndodhet zona e mbrojtur, AKZM-ja, nga institucionet vendore që kanë lidhje direkte me to, si të bujqësisë, të turizmit, të infrastrukturës, shoqërisë civile, përfaqësues nga pronarët e pyjeve e kullotave që gjenden në zonat e mbrojtura dhe drejtohen nga prefekti.

Inspektoriati, brenda detyrave dhe përgjegjësisive të caktuara në dispozitat ligjore në fuqi, kryen funksionet kontrolluese në ZM, pavarësisht nga forma e pronësisë së administrimit, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. AdZM është përgjegjëse për kryerjen e funksioneve kontrolluese në territorin e ZM. Procedurat e inspektimit bazohen në ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Inspektorët gjatë kryerjes së detyrës, gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, këtë atribut e gëzojnë dhe Drejtorët e AdZM-ve, përgjegjësit e sektorit të monitorimit në AdZM dhe AKZM, gjatë kryerjes së detyrës.

2.6 Ligj nr.10006, datë 23.10.2008“Për mbrojtjen e faunës së egër”.

(Fl.Z. nr.168/2008), ndryshuar me ligjin nr.41, datë 14.02.2013 (Fl.Z. Nr.30/2013) dhe ligjin 46, datë 18.07.2019 (Fl.Z. nr.111/2019).

Ligji emërtohet **“Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”** dhe ka për qëllim **konservimin e faunës së egër, mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e saj**, me synimin për të siguruar llojet, popullatat, habitatet, ku kjo faunë e egër jeton, si dhe për të plotësuar kërkesat e saj për ushqim, strehim e shumim, duke siguruar, në të njëjtën kohë, edhe rrugët e saj të shtegtimit, përfshirë vezët, foletë, të vegjlit dhe habitatet ku jetojnë të lira, përgjithmonë ose përkohësisht, në mjedise natyrore, tokësore e ujore, në territorin e RSh.

Me “Fauna e egër” është pasuri kombëtare dhe nënkuptohet tërësia e llojeve të egra, popullatat e tyre, të gjitha llojet e nënlojet e vertebrorëve, jovertebrorëve dhe popullatat e tyre, që jetojnë në gjendje të lirë në habitatin e tyre natyror, të vendosura në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në një territor të dhënë.

Sipas dispozitave të ligjit për mbrojtjen e faunës së egër duhen pasur parasysh: -Sigurimi i rivendosjes e mirëmbajtjes së **statusit të favorshëm të ruajtjes për faunën e egër** dhe i **mbrojtjes së veçantë për llojet** e saj; -Ruajtja dhe rehabilitimi i **habitateve natyrore, i rrugëve të shtegtimit** dhe i krijimit të kushteve për **shumimin e llojeve të faunës së egër**; - Rimëkëmbja e popullatave të pakësuara të llojeve, i mbrojtjes nga fatkeqësi natyrore dhe në rastet e dukurive epizootike; -Shmangia e **keqtrajtimit, e dëmtimit dhe e plagosjes** së individëve të llojeve gjatë veprimtarive bujqësore, hidroteknike, të mirëmbajtjes e shfrytëzimit të pyjeve dhe veprimtarive të tjera ekonomike e shoqërore që mund t'i dëmtojnë; -Krijimi i ZM, duke pasur si bazë habitatet e llojeve, shtimi “ex-situ” i llojeve të kërcënuara dhe endemike; -Mbrojtja e llojeve nga ndikimet negative të përhapjes e shumimit të llojeve invasive; -Kufizimi i përdorimit të llojeve të egra për qëllime koleksionimi dhe për çdo qëllim tjetër, rikthimi në natyrë i individëve të robëruar dhe krijimi i qendrave të shpëtimit të llojeve të faunës së egër.

Ministria, në bashkëpunim me ministritë e linjës, agjencitë ligjzbatuese, **njësitë e vetëqeverisjes vendore**, institute të specializuara, **OJF-t dhe** me persona fizikë e juridikë, harton **planet e veprimit për ruajtjen e llojeve** të kërcënuara dhe endemike.

Llojet e kërcënuara dhe endemike, të përcaktuara në **listën e kuqe**, gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore si dhe llojet ndërkombëtarisht të mbrojtura, të Konventës së Bernës.

Ministria, në varësi të ndryshimeve klimatike dhe të ndikimeve të tyre mbi faunën e egër, përgatit planet e ndërhyrjes e të veprimit për përbalimin e situatës. Masa të tilla zbatohen edhe për mbrojtjen nga përdorimi dhe administrimi i lëndëve, i mbetjeve të rrezikshme, i kimikateve bujqësore, shërbimin e mbrojtjes së bimëve e veterinare, në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi.

Ruajtja dhe përshtatja e popullatave të shpendëve të egër dhe shtegtarë, ndihmohen duke u siguruar një status të favorshëm ruajtjeje ekologjike, shkencore dhe kulturore, sipas përcaktimeve në ligj. Lista e llojeve të shpendëve të egër, **veçanërisht vulnerabël**, miratohet me urdhër të ministrit.

Në raste fatkeqësish natyrore, në zjarre, ngrica, përmytje, strukturat menaxhuese të pyjeve e kullotave, **organet e qeverisjes vendore, universitetet e qendrat kërkimore-shkencore dhe OJF-të hartojnë dhe zbatojnë programe e projekte përkujdesjeje për faunën e egër,** duke u siguruar strehim, ushqim dhe mjekim individëve të dëmtuar.

Për të mbrojtur, kurrar dhe riaftësuar individë të llojeve të faunës së egër, të kapur, të sekuestruar, të konfiskuar, të dëmtuar ose të braktisur, **krijohen qendrat e shpëtimit.**

Përdorimet e llojeve të faunës së egër përfshijnë: a) qëllime shkencore, kulturore, edukimi; b) koleksione zoologjike; c) përfitimin e produkteve jetësore ose për përdorimin e veprimtarive të tyre jetësore.

Përdorimi i individëve apo i llojeve të faunës së egër, të mbrojtur, **është i ndaluar,** por mund të lejohet vetëm për qëllime shkencore, kulturore dhe edukimi.

Në ligj percaktohen dhe llojet e veprimtarive të ndaluara.

Procesi i inventarizimit koordinohet dhe mbikëqyret nga ministria, me pjesëmarrjen e AKZM-së, strukturave përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në **bashki, instituteve kërkimore-shkencore, OJF-ve dhe të shoqatave që mbulojnë fushën e biodiversitetit.**

Ministria, në bashkëpunim me **universitetet, OJF, harton programin e biomonitorimit të faunës së egër dhe bashkërendon e kontrollon punën për zbatimin e tij.**

Në funksion të ruajtjes së numrit minimal të llojit e të shtimit të tyre, ministria **kompenson dëmet,** që mund t'u shkaktohen fermave bujqësore nga individët e llojit.

Personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike e shoqërore të cilat rezultojnë me ndikime negative mbi habitatet, rrugët e shtegtimin e kushtet e shumimit të llojeve të faunës së egër, detyrohen të respektojnë standardet e normat e lejuara të shkarkimeve në mjedis.

Pranë ministrisë përgjegjëse, ngrihet Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër (**KKFE**), si një organ konsultativ, për të kontribuar në lehtësimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore, që drejtohet nga zëvendësministri i ministrisë përgjegjëse për faunën e egër.

Kontrulli për mbrojtjen e faunës së egër është **veprimtari shtetërore,** që siguron zbatimin e dispozitave të ligjit, akteve nënligjore në zbatim të tij, dhe të konventave përkatëse, ku RSh është palë. Kontrulli organizohet dhe funksionon, nga struktura inspektuese, me synim evidentimin e ndikimeve negative natyrore dhe ndëshkimin e veprimeve antiligjore mbi faunën, në tërësi e mbi lloje të veçanta të saj.

Organet doganore, kontrollojnë importimin, eksportimin dhe tranzitimin e llojeve të faunës së egër, të gjalla, përfshi edhe vezët, që ato të jenë të pajisura me vërtetim nga ministria dhe me raport nga shërbimi veterinar.

2.7 Ligj nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”

(Fl.Z. nr.96/2020)

Qëllimi i ligjit është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, **për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik**, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

Dispozitat e ligjit përfshin **rregullimin e administrimit të sektorit të pyjeve**, organizimin institucional, rregullimin për përfitimet dhe shërbimet ndaj tij, për bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të angazhimeve ndërkombëtare ku RSh është palë, për të garantuar përmbushjen në vijimësi të funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturore në interes të të gjithë shoqërisë.

Në varësi të funksionit, shfrytëzimit, përdorimit, moshës, llojit të drurëve dhe bimësisë, **pyjet klasifikohen** në: Pyll i lartë (Trungishte), Pyll i ulët (Cungishte) dhe Shkurre. Ndërsa në varësi të funksionit që caktohen për të përmbushur, pyjet klasifikohen në: Pyje mbrojtëse, Pyje të mbrojtura dhe Pyje prodhuese.

Fondi pyjor kombëtar përbëhet nga: -Pyjet; -Tokat me bimësi pyjore, dhe sipërfaqet e zhveshura (çeltirat, shkëmbinjte dhe ranishtet që ndodhen në pyje); -Flora dhe fauna e egër, -Bimësia barishtore natyrore me vlera foragjere, mjekësore, eterovajore e tanifere, prodhimet e tjera pyjore e jopyjore dhe -Infrastruktura pyjore.

Në fondin pyjor kombëtar nuk përfshihen: Drurët e veçantë dhe grupet e drurëve, kudo që ndodhen, kur sipërfaqja që mbulojnë nuk plotëson kriterin për t’u konsideruar pyll, si dhe ata që ndodhen në një rresht rreth tokave bujqësore, anës rrugëve, kanaleve, vijave të ujit; Parqet urbane, sipërfaqet e pyllëzuara pranë monumenteve e varrezave, pavarësisht nga sipërfaqja e tyre; Drurët dhe shkurret industriale, që gjenden jashtë fondit pyjor kombëtar.

Në dispozitat e ligjit **përckatohen rastet e lejuara për heqjet nga fondi pyjor kombëtar** si: a) miratimi i ministrit, për sipërfaqe **deri në 1 ha**; b) VKM, për sipërfaqe **mbi 1 ha deri në 10 ha**; c) ligj të veçantë për sipërfaqe **mbi 10 ha**.

Në fondin pyjor kombëtar **ndalohet ndryshimi i destinacionit**: a) të sipërfaqeve të djegura në fondin pyjor; b) nëse cenon ruajtjen e biodiversitetit, stabilitetin e terrenit, regjimin e ujit, mbrojtjen nga rënia e gurëve dhe ortekëve, ruajtjen e peizazhit, si dhe rolin e pyjeve për mbrojtjen nga era.

Ndryshimet në sipërfaqe, destinacion dhe çdo elementi që lidhet me to, duhet të pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor (RKFP).

Cikli i plotë i **riinventarizimit kombëtar të pyjeve** është 8-vjeçar, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor. AKP ka përgjegjësinë për hartimin e metodologjisë, organizimin dhe drejtimin e punës për inventarizimin e pyjeve në nivel kombëtar.

Grupet kryesore të interesit përfshijnë **institucionet qendrore dhe vendore**, të cilat kanë përgjegjësi për **zhvillimin e sektorit dhe mbarëshkrimin e pyjeve, pronarët privatë të pyjeve, OShC**, profesionistët e fushës, shoqatat apo format e tjera të organizimit kolektiv të përdoruesve të pyjeve, bizneset që shfrytëzojnë produktet pyjore, si dhe komunitetet në zonat

rurale, jeta e të cilëve është drejtpërsëdrejti e lidhur me pyjet.

Me urdhër të ministrit ngrihet **Këshilli i Pyjeve (KP)**, që përbëhet nga profesionistë të fushës, të institucioneve akademike, **të shoqërisë civile**, organizimeve të përdoruesve të pyjeve, biznesit, individë me kontribut të veçantë në sektorin e pyjeve, i cili funksionon si një forum dhe u mundëson aktorëve të **parashatrojnë qëndrimet dhe interesat** e tyre në kuadër të harmonizimit dhe të ekuilibrit të interesave sektoriale, duke ofruar orientim, këshillim dhe opinione profesionale, jo të detyrueshme për institucionet, për qeverisjen e pyjeve.

Politikat në sektorin e pyjeve përcaktohen në Dokumentin e Politikave për Pyjet (**DPP**) dhe janë në përputhje e zërthejnë më tej politikat kombëtare, duke orientuar administrimin e sektorit, organizimin institucional, përfitimet nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar dhe shërbimet ndaj pyjeve.

Programi Kombëtar i Pyjeve (**PKP**) është dokument planifikimi strategjik, që realizohet me një **proces pjesëmarrës, gjithëpërfshirës, ndërsektorial**, për përmirësimin e mëtejshëm të qeverisjes së qëndrueshme të pyjeve.

Mbarështimi i pyjeve realizohet në përputhje me politikat dhe PKP, duke garantuar ruajtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e fondit pyjor kombëtar, sigurimin e kushteve për shfrytëzimin e tij në përputhje me prioritetet kombëtare.

Ministria është institucioni më i lartë politikëbërës dhe rregullator, që garanton zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit, duke koordinuar partneritetin me sektorët dhe aktorët e tjerë dhe ekuilibruar interesat sektoriale.

Agjencia Kombëtare për Pyjet (AKP) është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit, që ka si mision mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare.

AKZM garanton menaxhimin e qëndrueshëm, ruajtjen, rigjenerimin, përdorimin e FPK nën administrim, kontrollin dhe inspektimin e tij, si dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin e posaçëm për ZMM.

Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki është strukturë e specializuar në nivel vendor, me attribute menaxhuese, kontrolluese/inspektuese, teknike dhe këshillimore, që administron fondin pyjor kombëtar në pronësi, si dhe lëshon/pezullon/shfuqizon lejet për ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar për subjektet e interesuara.

Strukturat komunitare në fshat (kryetari i fshatit dhe kryesia e fshatit) kujdesen për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve në fshat në përputhje me nevojat dhe politikat për zhvillimin e zonave rurale.

Bashkitë ngrenë strukturën përgjegjëse për pyjet brenda territorit të tyre, me personel me arsim profesional dhe të lartë pyjor, duke garantuar një raport të drejtë gjinor. Inspektorët e strukturave kontrolluese/inspektuese të pyjeve në bashki, bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet.

Bashkitë dhe AKZM janë përgjegjëse për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e

infrastrukturës në FKP, që kanë nën administrim. Për fondin pyjor privat kjo infrastrukturë ndërtohet nga pronarët.

AKP, në bashkëpunim me bashkitë, AKZM, mbikëqyr ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në pyje, ofron mbështetje teknike dhe financiare kur investimet në infrastrukturë realizohen me financimet e buxhetit të shtetit.

Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki dhe AKZM vlerësojnë shërbimet e ekosistemit, që mundësojnë pyjet nën përgjegjësinë e tyre, si përfitime që njerëzit marrin prej pyjeve.

Veprimtaritë e shfrytëzimit në FKP, kur kryhen nga **strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki,** dhe nga **banorët apo pronarët** për nevojat e tyre, mund të realizohen vetëm nga individë apo subjekte të licencuara.

Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të FPK bëhet në bazë të kontratave të nënshkuara nga **kryetari i bashkisë dhe organi përgjegjës për ZMM.** Gjithashtu, dhe shfrytëzimi i prodhimeve jodrusore dhe nga legjislacionin për bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore dhe në mbështetje të kriterëve dhe kontigjentëve të caktuar nga ministria.

Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, mbi bazën e planifikimit dhe të lejeve që lëshon për subjektet grumbulluese pyjore jodrusore (përfshirë bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore) transportohen dhe shiten pasi të jenë pajisur me certifikatë origjine.

Shfrytëzimi i materialit drusor lejohet në FPK për qëllime të përfitimit ekonomik dhe vetëm nëpërmjet kryerjes së punimeve të parashikuara në **planet e mbarështimit.**

Shitja e lëndës drusore nga **bashkitë bëhet me ankand.**

Shërbimi ndaj FPK ka si **qëllim mbrojtjen, trajtimin dhe kryerjen e punimeve silvikulturore e të punimeve të tjera në fondin pyjor,** të cilat mundësojnë sigurimin e funksioneve ekologjike dhe shoqërore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, vjeljen e prodhimeve pyjore, duke siguruar vazhdimësinë e prodhimeve pyjore, të burimeve të tjera dhe të gjeneratës së re të masivit pyjor.

Trajtimi i pyjeve bazohet në masat dhe rekomandimet e planifikuara në planet e mbarështimit nëpërmjet planeve operacionale vjetore, të cilat zbatohen nga strukturat që administrojnë pyjet, pronarët privatë, si dhe nga të gjithë personat, juridikë e fizikë, që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar.

Mbrojtja e pyjeve përfshin masat parandaluese, vëzhgimin e situatës në pyje dhe evidentimin e dëmeve apo sinjalizimin e pranisë së faktorëve dëmtues, rikuperimin e dëmeve dhe rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara si pasojë e faktorëve dhe fenomeneve, që cenojnë dhe dëmtojnë fondin pyjor kombëtar.

Ndalohet ndezja e zjarreve në FPK, publik apo privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për përhapjen e pakontrolluar të tyre. Strukturat përgjegjëse për pyjet, kur vërejnë se bimët dhe prodhimet pyjore janë të infektuara nga parazitë karantinorë dhe janë kryer shkelje të kuadrit ligjor në fuqi, bëjnë menjëherë bllokimin dhe njoftojnë jo vetëm pronarin ose përdoruesin, por edhe eprorët për arsyet e

bllokimit.

Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki **hartojnë planet e përmirësimit të fondit pyjor kombëtar** që kanë nën administrim, ku planifikohen të gjitha ndërhyrjet dhe shërbimet për parandalimin e degradimit të fondit pyjor kombëtar dhe rehabilitimin e tij. Punimet mbrojtëse dhe ripërtëritëse në fondin pyjor kombëtar kryhen për të parandaluar ose kufizuar veprimet shkatërruese në pyll.

Rehabilitimi i ekosistemeve pyjore, i tokave pyjore të degraduara e të braktisura, i peizazhit pyjor, i habitateve të florës e faunës së egër kryhet nën **drejtimin e strukturave përgjegjëse për pyjet**.

Krijimi i rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjra ose pothuajse të virgjra, si dhe kalimi i tyre në konservim të plotë bëhen në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me VKM.

Funksioni i kontrollit ushtrohet nga: a) struktura përgjegjëse në agjenci; b) struktura përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki; c) struktura përgjegjëse në ZMM.

2.8 Ligj nr.10253, datë 11.03.2010 “Për gjuetinë”.

(Fl.Z. nr.39/2010), ndryshuar me ligjin nr.43/2013, datë 14.2.2013 (Fl.Z. nr.30/2013).

Ligji ka si qëllim: a) përcaktimin e **rregullave e të kërkesave për zhvillimin e gjuetisë, si një veprimtari tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike**; b) menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj; c) garantimin që parimet për gjuetinë të zbatohen në mënyrë rigorozë, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike; ç) mosdëmtimin e llojeve të faunës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjuetisë; d) respektimin e së drejtës së gjuetisë dhe të të drejtave mbi gjahun, mbi trofetë e produktet e gjuetisë dhe të tregtimit të tyre.

Gjuetia ushtrohet vetëm mbi individë të llojeve të faunës së egër, që janë **shpallur objekt gjuetie me VKM**. Nuk janë objekt i ushtrimit të gjuetisë dhe nuk lejohen të gjuhen individët: a) të llojeve të mbrojtura nga **konventat ndërkombëtare**, ku RSh është palë; b) e llojeve të faunës së egër, që janë **të rralla, të kërcënuara, në rrezik zhdukjeje** dhe që bëjnë pjesë në listën e llojeve të mbrojtura; c) e të **gjitha llojeve të shpendëve të egër migratorë**, të cilët, pas vlerësimit të popullatave të tyre, rezultojnë shumë të rrallë.

Gjuajtja e individëve të llojeve të ndaluara, mund të bëhet në rastet: a) e shtimit intensiv dhe të pakontrolluar të popullatës së një lloji; b) e shfaqjes së situatave episodike në llojet e faunës së egër; c) e shkakimit të dëmtimeve të vazhdueshme nga individët e një lloji.

Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë (**PKZhGj**) pasqyron synimet dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të gjuetisë, metodat dhe rrugët për arritjen e tyre. Hartohet nga ministria për një periudhë 10-vjeçare dhe **miratohet me VKM**.

Përpara çeljes së sezonit të gjuetisë, menaxhuesit e zonave të gjuetisë hartojnë planin vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, pa të cilin gjuetia nuk mund të ushtrohet në asnjë zonë.

Gjuetia ushtrohet vetëm brenda **sezonit të hapur për gjueti**, i cili përcaktohet sipas kriterëve gjeografike, klimatike e biologjike dhe miratohet me VKM, me propozimin e ministrit. Për çdo vit, ministria publikon hapjen e sezonit të gjuetisë në faqen e saj të internetit.

Kohëzgjatja e gjuetisë sipas llojeve dhe ditët e lejuara për gjueti, brenda sezonit të gjuetisë, caktohen me urdhër të veçantë të ministrit. Problemet në lidhje me administrimin dhe përgjegjësitë institucionale, për këtë sektor, ende nuk janë shumë të qarta, si rrjedhojë ky ligj nuk zbatohet plotësisht. Ndryshimet e bëra në strukturat qendrore dhe locale dhe zhvillimet e rjeda kërkojnë që të hartohet një ligj i ri...

2.9 Ligj nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor“.

(Fl.Z. nr.36/2007), ndryshuar me ligjin nr.14, datë 16.02.2012 (Fl.Z. nr.14/2012), ligjin nr.38, datë 14.02.2013 (Fl.Z. nr.30/2013) dhe ligjin nr.49, datë 05.05.2016 (Fl.Z. nr. 92/2016).

Ligji synon të sigurojë një **trajtim bashkëkohor të kullotave dhe livadheve**, përcaktimin e **kapacitetit dhe ruajtjen e balancës ekologjike të fondit të kullotave**, nëpërmjet unifikimit të kërkesave dhe **rregullave që lidhen me marrëdhëniet, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e shtetit, dhe institucionet lokale**, organizatat kërkimore shkencore të specializuara, pronarët privatë dhe bizneset.

Fondi kullosor është burim natyror dhe pjesë e pasurisë kombëtare. Mbrohet, administrohet dhe përdoret sipas kërkesave të ligjit dhe përmbledh: a) kullotat dhe livadhet; b) sipërfaqet pyjore me drurë e shkurre, që shërbejnë si kullota; c) bimësinë barishtore, drurët, shkurret e bimët mjekësore, eterovajore e tanifere, natyrore, që rriten në kullo ta e livadhe; ç) infrastrukturën e kullotave; d) sipërfaqet shkëmbore apo moçalore në përbërje të kullotave.

Fondi kullosor ndahet në: a) fond kullosor shtetëror, në **pronësi të bashkisë**; b) fond kullosor privat, në pronësi private.

Kullotat, livadhet dhe sipërfaqet me drurë e shkurre ose me bimësi pyjore, që përdoren për kullotje, klasifikohen në: Kullota verore dhe Kullota dimërore.

Kullotat e livadhet inventarizohen çdo 10 vjet. Kullotat dhe livadhet regjistrohen në regjistrin zyrtar të fondit kullosor, që krijon bazën e të dhënave për kullotat e livadhet në shkallë vendi, **qarku, bashkie dhe për çdo ekonomi kullosore**.

Heqja e një kullote apo livadhi nga fondi kullosor ose ndryshimi i destinacionit bëhet: a) për sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit; b) për sipërfaqe mbi 1 ha, me VKM.

Ruajtja, trajtimi e përdorimi i kullotave dhe livadheve realizohen duke zbatuar kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjia dhe plani i veprimit për kullotat e livadhet janë dokumente shtetërore, që shprehin politikën e shtetit shqiptar për të sotmen dhe ardhmërinë e kullotave, ku mbështeten të gjitha veprimtaritë për ruajtjen, trajtimin dhe përdorimin e fondit kullosor. Strategjia hartohet për një periudhë 10-vjeçare. Planet e veprimit, hartohen e zbatohen për periudha deri 3-vjeçare.

Kullotat dhe livadhet trajtohen dhe përdoren në përputhje me **planet e mbarështimit dhe të inventarizimit**, që hartohen nga **strukturat përkatëse të pyjeve dhe kullotave, njësitë e qeverisjes vendore, pronarët privatë** për një periudhë 10-vjeçare.

Dhënia në përdorim për kullotje bëhet në përputhje me **aftësitë mbajtëse kullosore**, të përcaktuara në planin e mbarështimit për çdo ngastër ose nënngastër, në bazë të një kontrate.

Vjelja e bimëve mjekësore, në kullota e livadhe, bëhet nga persona fizikë dhe juridikë, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për mbrojtjen e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore".

Djegia e kullotave dhe livadheve nga pronari, nga përdoruesi apo nga persona të tjerë është e **ndaluar** dhe ndëshkohet, sipas rastit, në përputhje me dispozitat e ligjit ose, me dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

Në fondin kullosor ndalohet çdo veprim, që dëmton mbulesën barishtore e shkurre e kullotave, që shkakton ndotjen e mjedisit dhe prish ekuilibrin ekologjik të tyre.

Ministria është organi qendror përgjegjës për hartimin e politikave dhe kuadrit ligjor, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të fondit kullosor si dhe përgjegjës për mbrojtjen dhe miradministrimin e fondit kullosor, pjesë e ZMM.

Bashkitë janë pronarë të kullotave shtetërore që gjenden brenda territorit administrativ të tyre dhe kanë këto kompetenca: a) ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet; b) hartojnë, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit; c) marrin masa për parandalimin e zjarreve dhe për shuarjen e tyre; ç) raportojnë në ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet të dhënat, që u kërkohen për inventarizimin dhe regjistrimin në regjistrin e fondit kullosor të kullotave dhe livadheve; d) njoftojnë ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet për infeksionet dhe dëmtuesit, që shfaqen në kullota e livadhe.

Ushtrimi i kontrollit dhe dokumentimi i tij bëhen nga organet e kontrollit, të përcaktuara në nenet e ligjit, dhe në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

2.10 Ligj nr.10120, datë 23.4.2009 "Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore".

(Fl.Z. nr.62/2009), ndryshuar me ligjin nr.42, datë 14.02.2013 (Fl.Z.nr.30/2013).

Qëllimi i këtij ligji është **mbrojtja e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore**, që rriten në territorin e RSh, duke zbatuar masa mbrojtëse e administruese për këto lloje bimësh; duke respektuar kërkesat teknike për vjeljen e mbledhjen e tyre; duke nxitur e përkrahur veprimtaritë për rehabilitimin e për kultivimin e tyre.

Pronësia mbi BMET-të buron nga pronësia e tokës, ku ato rriten e zhvillohen dhe njësohen me të: a) llojet që rriten në pronë **shtetërore**; b) llojet, që rriten në pyjet e kullotat **bashkiake**; c) llojet, që rriten në pyje e kullota pronë **private**.

Llojet e kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje, të përfshira **në listën e kuqe**, gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore.

Administrimi dhe trajtimi i fondit të BMET-ve organizohen dhe drejtohen nga **ministria**, zbatimi praktik i tyre është përgjegjësi e **strukturave të përkëtesë** dhe realizohet në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Veprimtaritë për ruajtjen, trajtimin dhe përdorimin e fondit të BMET-ve mbështeten në

strategjinë dhe planet e veprimit, për ruajtjen dhe zhvillimin e këtij fondi.

BMET-të administrohen në përputhje me **planet e mbarështimit dhe të inventarizimit**. Fondi i BMET-ve, inventarizohen çdo 5 vjet dhe rezultatet e tij pasqyrohen në regjistrat, që administrohen nga drejtoritë vendore të shërbimit pyjor, nga drejtoria përkatëse në ministri.

Llojet e BMET-ve me popullata të pakësuara, të rralla e në rrezik zhdukjeje, i nënshtrohen rehabilitimit, duke shtuar popullatat e tyre dhe duke shmangur ose zbutur ndikimet negative të faktorëve, që i kanë rrezikuar.

Për të kultivuar lloje të ndryshme të BMET-ve, personat juridikë e fizikë mund të marrin në përdorim edhe sipërfaqe të degraduara të fondit pyjor e kullosor, duke zbatuar procedurat e këtij ligji.

Në **veprimtaritë e ndaluara** përfshihen: a) vjelja, mbledhja, grumbullimi i BMET-ve në sipërfaqet pyjore e kullosore, pronë shtetërore; b) vjelja, mbledhja, grumbullimi i BMET-ve, në kundërshtim me kalendarin e vjeljes e të grumbullimit të secilit lloj; c) vjelja, mbledhja, grumbullimi i BMET-ve me mjete, mënyra e forma, që rrezikojnë ekzistencën e llojit e që çojnë në shkatërrimin e tyre; ç) kryerja e veprimeve, që bien në kundërshtim me kërkesat e kriteret teknike; d) mbledhja e BMET-ve të rralla, të kërcënuara, në rrezik zhdukjeje, të shpallura si të tilla në listën e miratuar nga ministri.

Për BMET-të, që rriten në fondin pyjor e kullosor, në fillim të çdo viti, miratohen: a) zonat ku do të vilen e mblidhen këto bimë; b) afatet dhe kalendarin e vjeljes për secilin lloj; c) llojet që do të vilen, mblidhen e grumbullohen.

Transporti i BMET-ve nga pikat e grumbullimit, në fshatra e bashki, për në pikat e përpunimit dhe për eksport, **shoqërohet me një vërtetim, të lëshuar nga organet kompetente ose nga qeverisja përkatëse vendore.**

Monitorimi i fondit dhe i llojeve përbërëse të tij nënkupton përfshirjen e tyre në kërkesat e programeve të biomonitorimit, që programohen dhe realizohen si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Procesi i inspektimit, konstatimit të shkeljes, pasqyrimin të saj dhe dënimit bëhet në përputhje me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2.11 Ligj nr.64, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”.

(Fl.Z. nr.73/2012)¹, ndryshuar me ligjin nr.80, datë 04.05.2017 (Fl.Z.nr.114/2017) dhe ligjin nr.4, datë 07.02.2019² (Fl.Z.nr.21/2019).

Qëllimi: a) sigurimin e një **shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme dhe detare** të RSh; b) përcaktimin e rregullave për **bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit**, nëpërmjet përfshirjes së komuniteteve përkatëse në proceset e vendimmarrjes; c) përcaktimin e **masave të ruajtjes, që garantojnë mbrojtjen e burimeve biologjike detare dhe ujërave të brendshme**; ç) nxitjen dhe përkrahjen e kërkimit shkencor e teknologjik dhe grumbullimit të të dhënave në peshkim; d) sigurimin e funksionimit dhe menaxhimit të porteve e të qendrave të peshkimit; dh) hartimin dhe sigurimin e një politike strukturore, me qëllim ristrukturimin e sektorit të peshkimit, sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, forcimin e konkurrencës e zhvillimit

ekonomikisht të vlefshëm të subjekteve të peshkimit, rigjallërimin e zonave që varen nga peshkimi, si dhe përmirësimin e furnizimit të tregut dhe rritjen e vlerës së prodhimit; e) përcaktimin e masave dhe rregullave të nevojshme për kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e politikave të peshkimit, në përputhje të plotë me politikat evropiane në këtë drejtim; ë) ngritjen e një sistemi kontrolli për peshkimin dhe vendosjen e procedurave të inspektimit të standardizuara dhe të koordinuara si në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

Ligji rregullon veprimtarinë e **peshkimit në tërësi, menaxhimin e tij, siguron mbrojtjen e gjallesave detare dhe të ujërave të brendshme**, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm në aktivitetin në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të RSh.

Aktivitetet peshkimi janë veprimtaritë e lidhura me kërkimin e peshkut, me lëshimin, vendosjen dhe tërheqjen e mjeteve të peshkimit, transferimin në bord të zënieve, trasbordimin, ruajtjen në bord, transformimin në bord, transferimin, vendosjen në kosha, majmërinë dhe shkarkimin e peshqve dhe produkteve të peshkimit.

Menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit ujor dhe gjallesave të tyre dhe shfrytëzimi kryhet në harmoni me **zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, mjedisor dhe social, i burimeve të gjallesave të ujërave detare dhe ujërave të brendshme**.

Ministri, me qëllim përdorimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e llojeve vendos mbylljen e sezonit dhe/ose të **ndalojë përdorimin e veglave dhe mjeteve të caktuara për peshkimin tregtar apo çlodhës-argëtues**, për llojet e veçanta të peshkut e të organizmave të tjerë detarë dhe të ujërave të brendshme nga mbipeshkimi, mbrojtjen e llojeve ekonomikisht të rëndësishme të peshkut dhe të organizmave të tjerë ujorë, peshkimin në zonat e veçanta, në zonën e portit, rrugët e hyrjes, si dhe vendet e ankorimit si dhe peshkimi me trata koçe, draga, kurthe, koshilok, trata zalli, trata krahu bregdetare dhe rrjeta të ngjashme në fundet me bimësi, sidomos të **Posidonia oceanica dhe fanerogameve të tjera detare**.

Mbikëqyrja, menaxhimi e rregullimi i peshkimit dhe i aktiviteteve që kanë lidhje dhe e mundësojnë atë bëhet nga **ministra**.

Llojet e peshkimit janë: a) peshkim tregtar; b) peshkim çlodhës-argëtues; c) peshkim për qëllime studimore dhe shkencore.

Numri maksimal i lejeve të peshkimit tregtar përcaktohet nga ministri në zbatim të PMP dhe planit të zbatimit të peshkimit.

Drejtoria e peshkimit është institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës krijon dhe administron Regjistrin e Peshkatarëve Profesionistë (**RPP**).

Peshkimi çlodhës-argëtues ndahet në tri kategori të veçanta: a) Peshkim amator, b) Peshkim sportiv, c) Peshkim turistik.

Peshkimi për qëllime studimore dhe shkencore kryhet vetëm në bazë të autorizimit të lëshuar nga ministri, ku përcakton kushtet, në të cilat mund të kryhet peshkimi për qëllime studimore dhe shkencore.

Me qëllim bashkëmenaxhimin e ujërave të brendshme, ministria bashkëpunon me **organizatat e menaxhimit të peshkimit (OMP)**, me qëllim që të ruhet ekuilibri ekologjik

dhe shfrytëzimi racional i burimeve peshkore të këtyre zonave.

Çdo hapësirë gjeografike e caktuar e ujërave të brendshme mund të përcaktohet me VKM si zonë bashkëmenaxhuese e peshkimit. Çdo plan bashkëmenaxhimi miratohet për një periudhë jo më shumë se 10 vjet.

Autoriteti përgjegjës për monitorimin e aktivitetit të peshkimit, i sforcos së peshkimit dhe akuakulturës është **Inspektorati i Peshkimit, sektori i monitorimit të peshkimit dhe Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)**.

Në zbatim të ligjit, inspektorët për peshkimin kontrollojnë në territorin shqiptar të gjitha stadet e tregtimit të peshkut dhe të produkteve të akuakulturës, që nga shitja e parë deri në shitjen me pakicë, duke përfshirë këtu dhe transportin.

Inspektorët që mbulojnë fushën e peshkimit bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit, organet tatimore dhe doganore, Policinë Bashkiake, Rojën Bregdetare, kapitaneritë e porteve, QNOD-in, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit si dhe çdo autoritet tjetër përgjegjës, të përcaktuar me VKM, si pjesë përbërëse e inspektoratit shtetëror kompetent, bazuar në këtë ligj dhe në ligjin nr. 10 433, datë 10.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2.12 Ligji nr.111, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

(Fl.Z. nr.111/2012), ndryshuar me ligjin nr.8, datë 08.02.2018 (Fl.Z.nr.30/2018)

Qëllimi: a) **mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre;** b) **sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore,** të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit; c) **shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit** dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre; ç) **mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike;** d) **përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor,** për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mire të komunitetit dhe interesave socialë dhe ekonomikë të vendit.

Dispozitat e ligjit rregullojnë marrëdhëniet juridike që lindin nga përdorimi i burimeve ujore në RSh dhe zbatohen për: a) **ujërat brendshme detare, ujërat territoriale, vijën bregdetare, zonën ekonomike ekskluzive, shelfin kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike, ujërat ndërkufitare, burimet natyrore dhe ujërat e lagunave e zonat e mbrojtura;** b) **ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, me përjashtim të ujërave minerale dhe gjeotermale që janë të përshtatshme për nxjerrjen e lëndëve të para minerare ose shfrytëzimin e energjisë termike të akumuluar për qëllime të prodhimit të energjisë, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.**

Janë në **pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:** a) të gjitha burimet ujore të RSh; b) të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë,

ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore; c) toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit; ç) të gjitha strukturat dhe punimet hidroteknike të realizuara nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet, si dhe punimet që lidhen me to.

Organet qendrore për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore janë: a) Këshilli i Ministrave (KM); b) Këshillit Kombëtar i Ujit (KKU); c) Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU). Ndërsa baseni bëhet nëpërmjet: a) Këshillave të Baseneve Ujore (KBU); b) Zyrave të Administrimit të Baseneve Ujore (ZABU), degë të AMBU-së.

KKU, është organi ndërministror qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore dhe kryesohet nga Kryeministri.

AMBU, është person juridik shtetëror, që financohet nga buxheti i shtetit. AMBU-ja organizohet në nivel qendror dhe në nivel baseni ujqor nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujore, ndër të tjera, ushtron funksionet e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU).

KBU, është organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në basenin përkatës, në nivel vendor.

AZBU, është struktura në varësi të ministries dhe funksionon në çdo basen ujqor.

Me VKM territori i Shqipërisë, në funksion të menaxhimit të burimeve ujore, **ndahet në shtatë basene ujore**: 1. Baseni ujqor Drin-Bunë, me qendër në Shkodër; 2. Baseni ujqor Mat, me qendër në Lezhë; 3. Baseni ujqor Ishëm, me qendër në Durrës; 4. Baseni ujqor Erzen, me qendër në Tiranë; 5. Baseni ujqor Shkumbin, me qendër në Elbasan; 6. Baseni ujqor Seman, me qendër në Fier; 7. Baseni ujqor Vjosë, me qendër në Vlorë.

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore (**SKMBU**) është një dokument planifikimi që **përcakton vizionin e politikave të shtetit, misionin, qëllimet dhe objektivat në fushën e menaxhimit të integruar të ujërave** për një periudhë afatgjatë, një dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave për zhvillimin e planeve dhe dokumenteve të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, shëndetit publik dhe përmban edhe dokumente të tjera përkatëse. SKMBU rishikohet çdo 15 vjet.

Planet e menaxhimit të baseneve ujore (**PMBU**) hartohen në përputhje me SKMBU dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar.

Objektivat mjedisorë për trupat me ujëra sipërfaqësore, nëntokësore, dhe për zonat e mbrojtura vendosen me qëllim parandalimin e dëmtimit të trupave ujqorë, si dhe mbrojtjen, shtimin dhe rehabilitimin e të gjithë trupave ujqorë, si sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, duke marrë në konsideratë statusin e tyre kimik, ekologjik dhe sasior.

Zonat e mbrojtura, në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, përfshijnë masa të veçanta mbrojtëse, si: a) **zonat higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore**; b) **zonat e mbrojtura**, të ligjit për ZMM; c) **zonat për peshkim dhe rritjen e butakëve**; ç)

zonat për banjat termale, për trajtimin kurativ dhe rekreacion; d) zonat e prirura ndaj **eutrofikimit dhe zonat në rrezik nga nitratat e nitritet**; dh) zonat e synuara për **mbrojtjen e bimëve apo kafshëve, si dhe të habitateve**.

Burimet ujore përdoren për: a) qëllimet shtëpiake, komunale, bujqësore, përfshirë ujitjen dhe ujin për blegtorinë; b) akuakulturë, transport ujor, industrial, prodhim hidroenergetik; c) tregti; ç) turizëm, argëtim, përfshirë lundrimin për argëtim; d) qëllime të tjera, të miratuara nga K KU.

Sipas dispozitave të ligjit përcaktohen veprimtaritë që mund të kryhen në bazë të lejes **administrative të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore**.

Organet e menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë **leje administrative për shfrytëzimin** e materialeve inerte, si rërë, zhavorr, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë, vetëm në qoftë se plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore, të përcaktuara me akte të K KU.

K KU, në bashkëpunim me organet përkatëse shëndetësore dhe ato të **mbrojtjes së mjedisit**, përcakton zonat e rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve, që janë shpallur si të dëmshme për interesat publike dhe vendos tharjen e tokave që janë nën ujë.

Mbrojtja e brigjeve është detyrë publike. Veprimtaritë përbri brigjeve përcaktohen në planet dhe studimet e planifikimit dhe rregullimit të territorit. Këto dokumente miratohen paraprakisht në K KU.

Organet përgjegjëse të **planifikimit të territorit në njësitë e qeverisjes vendore** lëshojnë **leje për ndërtimin**, rindërtimin apo shembjen e objekteve mbrojtëse të brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje, vetëm pasi pajisen me autorizim të posaçëm nga organet e administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore.

Në dispozitat e ligjit për brigjet, plazhet dhe zonat e vërshimit përcaktohen veprimtaritë e ndaluara. Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me **strukturat dhe organet e qeverisjes vendore**, janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkaktuar në rast përmytjesh.

Organet e administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit dhe **organet e qeverisjes vendore**, kanë të drejtë të mbikëqyrin e të detyrojnë subjektet, persona fizikë apo juridikë, për instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private, si dhe të servituteve që nevojiten për hyrjen në instalime të tilla, për punën përgatitore dhe për ndërtimin.

AMBU, është organi që krijon, menaxhon dhe përditëson Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore (**KKBU**).

Inspektoratet, që mbulojnë fushën e mjedisit, shëndetësisë dhe bujqësisë, janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të ligjit nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së. Po kështu, Inspektorati, që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ARM janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të ligjit, në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj,

me ligjin për mbrojtjen e mjedisit” dhe me ligjin për inspektimin.

2.13 Ligj nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”.

(Fl.Z. nr.29/2002), ndryshuar me ligjin nr.10137, datë 12.06.2009 (Fl.Z. nr.86/2009), ligjin nr.30, datë 14.02.2013 (Fl.Z nr.30/2013).

Ligji ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të RSh nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.

Mbrojtja e mjedisit detar është detyrë e të gjitha organeve shtetërore qendrore dhe vendore, të cilët e kanë nën administrim, organizatat shoqërore dhe personat fizikë apo juridikë privat ose shtetëror që e përdorin ose shfrytëzojnë kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e mjedisit detar, si dhe ta mbrojnë atë nga ndotjet e dëmtimet.

Mjedisi detar përdoret dhe shfrytëzohet për veprimtari ekonomike, tregtare, shkencore, shoqërore, sportive, turistike e ushtarake.

Kontrolli i mjedisit detar dhe i veprimtarive që zhvillohen në të ushtrohet drejtpërdrejt nga **Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit**, nga kapitaneritë e porteve, nga organet shtetërore që kanë veprimtari të licencuara, si dhe nga organe të tjera të përcaktuara me ligj.

Në ligj përcaktohen **kategoritë dhe veprimet e ndaluara** në mjedisin detar si dhe rregullat për administrimin, largimin dhe dorëzimin e mbeturinave.

Përdoruesit e mjedisit detar që kanë shkaktuar ndotjen e mjedisit detar, detyrohen të pastrojnë zonën e ndotur, ta sjellin atë në gjendjen e mëparshme, si dhe të shpërblejnë dëmet. Kur kemi raste shkarkimesh të lëndëve që shkaktojnë ndotje në shkallë të lartë me dashje ose nga pakujdesia e rëndë përben vepër penale.

2.14 Ligj nr.93, datë 27.07.2015 “Për turizmin”.

(Fl.Z. nr.164/2015), ndryshuar me ligjin nr.114, datë 18.12.2017 (Fl.Z.nr.232/2017) dhe ligjin nr.101, datë 13.12.2018 (Fl.Z.nr.181/2018).

Qëllimi i ligjit është të **promovojë Shqipërinë si destinacion turistik tërheqës për vizitorë vendas e të huaj**, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt, dhe duke respektuar nevojat e komuniteteve pritëse të sotme dhe të brezave të ardhshëm.

Dispozitat e ligjit parashtrojnë: **Rregullimin e marrëdhënieve** ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizikë e juridikë, vendas apo të huaj; **Rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit** e të ndërveprimit të **organeve të qeverisjes qendrore me ato të qeverisjes vendore; Përcaktimin e rregullave për bashkërendimin e punës dhe bashkëveprimin** e institucioneve përgjegjëse në fushën e turizmit; dhe Rregullimin e

marrëdhënieve ndërmjet institucioneve shtetërore dhe investitorëve potencialë.

Turizmi dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me të mbështeten në **parimet e zhvillimit të qëndrueshëm**, në lidhje me **aspektet ekonomike, mjedisore e social-kulturore** dhe kërkojnë vendosjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet tyre, për zhvillim afatgjatë.

Organet përgjegjëse në fushën e turizmit janë: a) Ministria përgjegjëse për turizmin; b) Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit; c) Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT); ç) Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB); d) degët territoriale të turizmit; dh) inspektorati që mbulon fushën e turizmit; e) **njësitë e qeverisjes vendore**; ë) komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike.

Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit (**KKSPT**), krijohet si një organ këshillimor për sektorin e turizmi.

AKT, është personi juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës, që ka për qëllim promovimin e turizmit shqiptar, brenda dhe jashtë vendit.

AKB, është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës, që ka për qëllim mbrojtjen dhe ndjekjen e zhvillimit të zonës bregdetare shqiptare.

Në dispozitat e ligjit **përcaktohen detyra dhe përgjegjësi** edhe për **Njësitë e qeverisjes vendore**.

Pranë çdo **prefekturë krijohet Komitetet Rajonale të Zhvillimit të Turizmit (KRZhT)**, nën drejtimin e **prefektit të qarkut**.

Burimet turistike në RSh klasifikohen në: a) **Burime natyrore turistike**, ku përfshihen peizazhet natyrore, zonat e mbrojtura, veçoritë gjeografike e biologjike, kushtet klimatike, detare, hidrografike dhe objektet e tjera fizike, natyrore apo gjeomonumentale, që janë tërheqëse për turistët; b) **Burime njerëzore turistike**. Personat juridikë dhe fizikë, organet **publike qendrore e vendore** apo **personat privatë**, që zotërojnë ose administrojnë burime turistike, janë **përgjegjës për administrimin e tyre**.

Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për **bashkërendimin e veprimtarive të organeve publike, për mbrojtjen, rritjen dhe përdorimin e burimeve turistike**, për shndërrimin e tyre në produkte turistike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Ministria përgatit **planin kombëtar sektorial të turizmit** për gjithë territorin. KKT miraton zonat me **përparësi zhvillimin e turizmit**, si **zona të rëndësisë kombëtare**, në përputhje me **planin e përgjithshëm kombëtar dhe planin kombëtar sektorial të turizmit**.

Mbrojtja, ruajtja, përdorimi dhe zhvillimi me efikasitet i burimeve natyrore turistike, zhvillimi dhe operimi i një sipërmarrjeje turistike, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, bëhet në përputhje me **planin kombëtar sektorial të turizmit dhe të PIM të rrjetit të ZMM**.

Plani i zhvillimit dhe të veprimit përgatitet, në bashkëpunim me ministritë, **organet publike, organet e qeverisjes vendore, si dhe me grupet e interes**.

Pasuritë e paluajtshme, në pronësi të shtetit, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e

turizmit, **me përjashtim të zonave të mbrojtura dhe objekteve të trashëgimisë kulturore**, me VKM, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Pasuritë e paluajtshme, në **administrim të njërive të qeverisjes vendore**, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me VKM, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Në dispozitat e ligjit **përcaktohen rregulla për agjencitë e udhëtimit, operatorët turistik, licencimin** për ushtrimin e veprimtarisë dhe të ndërprerjes së saj. Udhërrëfyesi turistik ndahet në kategoritë: a) udhërrëfyes turistik kombëtar, personi, i cili mund të udhëheqë në të gjithë territorin e RSh; b) udhërrëfyes turistik lokal, personi, i cili mund të udhëheqë vetëm në një zonë të kufizuar; c) udhërrëfyes i specialitetit të veçantë, personi, i cili mund të udhëheqë veprimtari të turizmit të aventurës dhe të interesit të veçantë.

Inspektorati që mbulon fushën e turizmit është personi juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës dhe funksionon sipas këtij ligji dhe ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2.15 Ligj nr.10463, datë 22.09.2011“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

(Fl.Z. nr.148/2011), ndryshuar me ligjin nr.32, datë 14.02.2013 (Fl.Z.nr.30/2013) dhe ligjin nr.156, datë 10.10.2013 (Fl.Z.nr.172/2013).

Ligji ka për **qëllim të mbrojtë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve**, nëpërmjet: a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve; b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre; c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

Me “menaxhim të integruar të mbetjeve” kuptohet grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi ose riciklimin mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.

Menaxhimi i integruar i mbetjeve duhet bërë duke mbajtur në konsideratë sigurinë e shëndetit të njeriut dhe **mbrojtjes së mjedisit**, duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë ose mjedisin dhe sidomos: a) duke mos vënë në rrezik **ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët**; b) duke mos ndikuar negativisht mbi fshatin ose vendet me interes të veçantë; c) duke mos shkaktuar shqetësime përmes **zhurmave ose erërave**.

Efektiviteti i menaxhimit të integruar të mbetjeve arrihet duke mbajtur në konsideratë këtë hierarki: a) parandalimin e mbetjeve, b) përgatitjen për ripërdorim, c) riciklimin, ç) rikuperime të tjera, d) asgjësimin.

KM miraton **katalogun e mbetjeve**, në cilin jepet **lista e mbetjeve**, sipas origjinës dhe përbërjes së tyre dhe, aty ku është e nevojshme, edhe sipas vlerave kufi të përqendrimit të substancave të rrezikshme. Në këtë katalog përfshihen edhe mbetjet e rrezikshme.

Ministria harton Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (**PKMIMb**), në përputhje me objektivat dhe **parimet e mbrojtjes së mjedisit**, të përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Çdo qark harton **planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve**, në përputhje me PKMIMb dhe me kërkesat e ligjit.

Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore përcakton **rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve**, që gjenerohen në territorin e vet, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve, ose masën e gjelbër nga parqet a kopshtet e shtëpive.

Këto **rregulla** mund të jenë më strikte sesa qëllimet dhe kërkesat e përcaktuara në PKMIMb dhe miratohen nga **Këshilli i Qarkut (KQ)**, dhe dërgon për shqyrtim dhe miratim në KM planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Ministria harton programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit, të cilët janë pjesë përbërëse e dallueshme e PKMIMb.

Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (**KoMIMb**), krijohet si organizëm ndërministror, në nivel zëvendësministrash, për të bashkërenduar detyrat e ministrive.

Mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar, nuk përzihen me mbetje ose me materiale të tjera, që kanë veti të ndryshme nga të tyret. Mbetjet, që nuk rikuperohen u nënshtrohen operacioneve të sigurta të asgjësimit.

Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me parimin “Ndotësi paguan”, të përcaktuar në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”, mbulohen nga krijuesi fillestar i mbetjeve ose nga zotëruesi aktual apo i mëparshëm i tyre.

Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

KM **ndalon ose kufizon importin e mbetjeve**, që destinohet për incinerim, kur: a) një gjë e tillë është e nevojshme për të mbrojtur rrjetin e impianteve të trajtimit të mbetjeve; b) importe të tilla mundësojnë trajtimin ose asgjësimin e mbetjeve të vendit me mënyra që nuk përputhen me planet përkatëse të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhen nga subjektet të autorizuar vetëm në kushte që sigurojnë **mbrojtjen e mjedisit** dhe shëndetin të njeriut. Mbetjet e rrezikshme **nuk përzihen as me lloje të tjera mbetjesh të rrezikshme, as me mbetje, substanca apo materiale të tjera.**

Leja e mjedisit, që lejon përzierjen e mbetjeve të rrezikshme, jepet në rastet kur: a) përmbushen kërkesat e këtij ligji; b) menaxhimi i integruar i mbetjeve nuk rrit ndikimin negativ në shëndetin e njeriut dhe **në mjedis**; c) operacionet e përzierjes kryhen në përputhje me teknikat më të mira të disponueshme.

AKM dhe njësitë e qeverisjes vendore, nxisin: a) grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio për **qëllime kompostimi** dhe digjestimi; b) trajtimin e mbetjeve bio në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i **mbrojtjes së mjedisit**; c) përdorimin e materialeve të prodhuara nga mbetjet bio që janë të **sigurta për mjedisin.**

Ne dispozitatve të ligjit përcaktohet rastet e miratimit nga KM për kërkesat minimale për **ambalazhet**; për parandalimin e krijimit të mbetjeve të ambalazheve; për ngritjen e sistemeve për ripërdorimin apo rikuperimin për sasisë së mbetjeve nga ambalazhet që rikuperohen apo riciklohen dhe afatet për arritjen e tyre.

Gjithashtu, **miraton rregullat që ndalojnë prodhimin, hedhjen në treg dhe përdorimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm (NOQ)**; për hedhjen në treg të **baterive dhe akumulatorëve**; për parandalimin e **mbetjeve të automjeteve**; mbetjet nga **gomat e përdorura**; për përdorimin e **llumrave të ujërave të zeza në bujqësi**, me qëllim parandalimin e efekteve të **dëmshme mbi tokën, bimët, kafshët dhe njerëzit**; për menaxhimin e **mbetjeve spitalore**; për menaxhimin e **nënprodukteve të kafshëve**; për menaxhimin e **mbetjeve inerte**; për menaxhimin e mbetjeve nga kërkimet, nxjerrja, trajtimi dhe depozitimi i **burimeve minerare**, të mbetjeve në **gurorë**; për menaxhimin e mbetjeve të industrisë së **dioksidit të titanit** dhe të **mbetjeve të tjera industriale**; për parandalimin e **shkarkimit të mbetjeve**, të krijuara nga **anijet** dhe për menaxhimin e rrymave të tjera të **mbetjeve të ndryshme**.

Lendfillet klasifikohen në tri kategori: a) lendfille për mbetjet e rrezikshme; b) lendfille për mbetjet jo të rrezikshme; c) lendfille për mbetjet inerte.

Ky ligj **ndalon në mënyrë taksative**, në të **gjitha rastet, importet dhe kalimin transit ndërkuftar të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në RSh**.

KM miraton **listën e mbetjeve që lejohen të importohen dhe rregullat për zbatimin e tyre**. Me autorizim të ministrit mund të kalojnë transit përmes territorit të RSh mbetjet jo të rrezikshme apo mbetjet inerte si dhe mund të bëhet eksporti i mbetjeve.

Inspektimet për çdo operacion grumbullimi dhe transporti përfshijnë origjinën, natyrën, sasinë e mbetjeve të grumbulluara e të transportuara deri në destinacionin përfundimtar dhe kryhen nga inspektoriat që mbulon fushën e mjedisit.

2.16 Ligj nr.107, datë 31.07.2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

(Fl.Z. nr.137/2014), ndryshuar me ligjin nr.73, datë 09.07.2015 (Fl.Z. nr.126/2015), ligjin nr.28, datë 23.03.2017 (Fl.Z. nr.75/2017) dhe ligji nr.42, datë 04.07.2019 (Fl.Z. nr.128/2019).

Qëllimi: a) të sigurojë **zhvillimin e qëndrueshëm të territorit**, nëpërmjet **përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore**; b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të **balancimit të burimeve natyrore**, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për: i) **mbrojtjen e burimeve natyrore**, si: toka, në veçanti **toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet**; ...; c) të nxitë veprimet e duhura **për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit**; ç) të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese dhe sipas **legjislacionit mjedisor në fuqi**; ...; dh) të sigurojë që autoritetet **kombëtare e vendore të planifikimit të**

hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale; e) të sigurojnë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit.

Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit janë: 1. Në nivel qendror: a) Këshilli i Ministrave (KM); b) Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT); c) ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; 2. Në nivel qarku: a) Këshilli i qarkut (KQ); 3. Në nivel bashkie: a) Këshilli bashkiak (KB); b) Kryetari i bashkisë.

Ligji përcakton dhe përgjegjësitë e KM, të KKT, të ministrive të linjës për planifikimin dhe zhvillimin të territorit, të AKPT, të **Këshillit të Qarkut**, i cili është përgjegjës për koordinimin e proceseve të planifikimit në **nivel qarku dhe të Këshillit bashkiak**. Përgjegjësi janë përcaktuar dhe për **Kryetarin e bashkisë**.

Në RSh janë dy nivele të planifikimit të territorit: 1. **Planifikimi i nivelit qendror**, që kryhet përmes dokumenteve të planifikimit si vijon: -Plani i Përgjithshëm Kombëtar (**PPK**), për gjithë territorin e RSh; - Planet kombëtare sektoriale, për të gjithë ose një pjesë të territorit; - **Planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare** dhe 2. **Planifikimi i nivelit vendor**, që kryhet përmes dokumenteve të planifikimit si vijon: - Planet sektoriale në nivel qarku, - Plani i Përgjithshëm Vendor (**PPV**),.- Planet e Detajuara Vendore (**PDV**).

Autoriteti i planifikimit vendor përcakton në planin e përgjithshëm të territorit zonat, të cilat do t'i **nënshtrohen hartimit të PDV**, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në rregulloren e planifikimit. PDV është dokumenti që detajon përcaktimet e PPV në nivelin e një ose disa njësive strukturore dhe përcakton kushtet për zhvillimin e një zone përmes lejeve të ndërtimit.

Kërkesë për zhvillim është kërkesa e paraqitur pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit për lejimin e punimeve dhe ndërtimit, e cila përmban dokumentacionin e përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Certifikata e përdorimit është dokument zyrtar i lëshuar nga autoriteti përgjegjës në miratim të kërkesës, i cili vërteton se ndërtimi është në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit dhe se punimet e kryera dhe ndërtimi janë të përshtatshme për përdorim.

Kontroll i zhvillimit është procesi, në bazë të të cilit autoriteti përgjegjës i planifikimit vlerëson dhe vendos nëse një kërkesë për zhvillim, kërkesë për ndërtim, kryerja e punimit ose ndërtimit përputhet me dokumentet e planifikimit, zhvillimit dhe të kontrollit të zhvillimit, të miratuara, kodin e ndërtimit dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Deklaratë paraprake për kryerje punimesh është deklarata e depozituar pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit për punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit siguron një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi horizontal e vertikal, me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe **palët e interesuara**, përpara fillimit dhe gjatë hartimit të **dokumentit vendor** të planifikimit.

Infrastrukturë publike është tërësia e rrjeteve, instalimeve dhe e ndërtimeve ekzistuese ose

të parashikuara në territor, si dhe e hapësirave publike, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, të energjisë, administrimit të ujit, komunikimit elektronik, arsimit, shëndetësisë, **administrimit të mbetjeve** dhe **mbrojtjes së mjedisit**, **administrimit të burimeve natyrore** e kulturore, mbrojtjes kombëtare, civile e **kundër zjarrit** si dhe të tjera fusha të ngjashme në shërbim të publikut.

Kushte zhvillimore janë kushtet e përcaktuara nga **plani i detajuar vendor** ose, në mungesë, nga **plani i përgjithshëm vendor** dhe, në mungesë të të dyjave, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës i planifikimit që shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit të domosdoshëm për pajisjen me leje ndërtimi.

Planet e përgjithshme janë objekt ndryshimi, kur është e nevojshme dhe në çdo rast objekt rishqyrtimi të plotë, **çdo 15 vjet**. PPKT do të jetë subjekt vlerësimi, në përshtatje me faktorët e rinj, socialë, ekonomikë dhe *mjedisorë*, të paktën në fund të çdo 5-vjeçari, në përputhje me kornizën kohore të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (**SKZHI**).

Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit janë: 1. Këshilli Kombëtar i Territorit (**KKT**) dhe 2. **Kryetari i bashkisë**.

“**Rregullore e planifikimit**”, është rregullore e miratuar me VKM, që përcakton rregulla të unifikuara për përmbajtjen dhe strukturën e dokumenteve të planifikimit.

“**Rregullore e zhvillimit**”, është rregullore e miratuar me VKM që përcakton kushtet dhe procedurat e detajuara për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit dhe për përmbajtjen, strukturën dhe procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit.

“**Rregullore ndërtimi**”, është rregullorja e miratuar me VKM, që përcakton normat dhe kushtet teknike bazë të detyrueshme për garantimin e qëndrueshmërisë së strukturave, hapësirave të emergjencës, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, ruajtjen e energjisë dhe sigurinë e jetës, në lidhje me objektet e reja dhe ato ekzistuese, për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e përgjithshme të banorëve, si dhe për përshtatjen e hapësirave për përdorimin nga persona me aftësi të kufizuara.

“**Rregullore e Regjistrimit**”, është rregullore e miratuar me VKM që përcakton strukturën dhe standardet e përbashkëta gjeodezike dhe të GIS-it, rregullat për administrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave, si dhe detyrimet e autoriteteve publike dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë për sa i përket mirëmbajtjes dhe dorëzimit të dokumenteve dhe të dhënave në Regjistr.

“**Regjistër i integruar i territorit**”, është baza e të dhënave shtetërore, sipas përcaktimit të legjislacionit përkatës, në të cilin regjistrohen dhe administrohen nga autoritetet kombëtare dhe vendore, në mënyrë të pavarur, të dhënat për tokën e zhvillimet në të, dokumentet e planifikimit dhe të zhvillimit, në proces miratimi apo të miratuara, kërkesat për zhvillim dhe ndërtim, si dhe lejet e zhvillimit, ndërtimit apo certifikatat e përdorimit, së bashku me të drejtat apo kufizimet ligjore, që rrjedhin prej tyre, si dhe studime apo materiale të tjera me interes për publikun, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

“**Leje ndërtimi**”, është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse. “**Leje zhvillimi**”, është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një

parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi.

Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2.17 Ligj nr. 139, datë 17.12. 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

(Fl.Z nr. 249, dt 31.12.2015), ndryshuar me ligjin nr. 38, datë 20.6.2019.

Ky ligj rregullon **organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore** në Republikën e Shqipërisë, si dhe **përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.**

Misioni i vetëqeverisjes vendore, siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. **Parimet themelore** të vetëqeverisjes vendore, veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore dhe respektojnë e zbatojnë **Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet. Të drejtat dhe përgjegjësitë e vetëqeverisjes, përfshijnë: pronësinë; mbledhjen e të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve; kryerjen e veprimtarive ekonomike; të bashkëpunimin; personin juridik.

Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore, bazohen në parimet e subsidiaritetit, **të konsultimit dhe të bashkëpunimit** për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për **politikat, legjislacionin dhe normat që rregullojnë** dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësive.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore **garantojnë për publikun transparencën** e veprimtarisë së tyre. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë **koordinatorin e transparencës** dhe të miratojë **programin e transparencës.**

Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë **pjesëmarrjen publike** në **procesin e vendimmarrjes** dhe është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik.

Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, përbëhet nga disa njësi administrative. Organi përfaqësues i bashkisë është **këshilli bashkiak**. Organi ekzekutiv i bashkisë është **kryetari i bashkisë**. Organet përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkisë zgjidhen në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave.

Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. **Çdo shtetas lejohet** të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.

Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa,

ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore.

Çdo komunitet, ka të drejtë të paraqesin për **vendimmarrje në këshillin bashkiak** iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe funksione të deleguara.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen, nëpërmjet **shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore** dhe **grupeve të tjera të interesit**, nëpërmjet të cilit u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikatat dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre.

Në dispozitat e ligjit **përcaktohen Funksionet e bashkive**: në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike; në fushën e shërbimeve sociale; në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese; në **fushën e mbrojtjes së mjedisit** si:1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për **mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja**.2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për **mbrojtjen nga ndotja akustike**.3. Zhvillimin e **aktiviteteve edukuese dhe promovuese**, në nivel vendor, të cilat lidhen me **mbrojtjen e mjedisit**.4. **Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit**.

Po ashtu **Funksionet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit** si; 1. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e **infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit**, të transferuar në pronësi të tyre. 2. Administrimin dhe **mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve**, si toka të pafrytshme etj,. 3. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të **informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural**. 4. Krijimin dhe administrimin e **skemave vendore të granteve** për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke **garantuar akses të balancuar gjinor**. 5. **Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik**,. 6. **Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi**.

Në Funksionet e bashkive përfshihet edhe **fusha e zhvillimit ekonomik vendor**; fusha e **sigurisë publike** dhe **fusha e diasporës dhe të migracionit**.

Në këto dispozita përcaktohen: **Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore**; Përbërja, krijimi, mënyra e organizimit, kompetencat dhe detyrat e **Këshillit bashkiak**; Mënyra e zgjedhjes e Këshilli bashkiak; Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak; Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit; Mbledhja e parë e këshillit bashkiak; Mandati i këshilltarit; Betimi; Të drejtat e këshilltarit; Kushtet e pengesës ligjore, vete deklarimi dhe perjashtimi.

Funksionimi, Detyrat dhe kompetencat e **Këshillit Bashkiak**; si dhe për **Kryetari i këshillit bashkiak**; Sekretari i këshillit bashkiak; Shpërndarja e parakohshme e këshillit bashkiak;

Në dispozitat e ligjit përcaktojnë: Kompetencat, detyrat dhe funksionet e **Kryetari i bashkisë**; Mandati i tij; Shkarkimi dhe Simboli i kryetarit të bashkisë

Dispozitat e ligjit përcaktojnë drejtimin dhe funksionimin e **strukturave administrative të**

bashkisë, të Administratës së njësisë administrative dhe të detyrave të saj.

Po ashtu përcaktohen edhe **detyrat dhe të drejtat e këshillit dhe ndërlidhësit komunitar. Struktura komunitare në fshat drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit.**

Detyrat dhe të drejtat e **kryetarit dhe të kryesisë së fshatit** konsistojnë në: mbështesin funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në fshatin e tyre, si dhe kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, **përdorimin e burimeve të përbashkëta** dhe sigurimin e harmonisë sociale, kryesisht në: a) kujdesjen për **parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme** në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara, si dhe rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit; b) kujdesjen për **parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme** dhe të çdolloj dëmtimi të rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike në fshat; c) administrimin e varrezave të fshatit; ç) **kujdesjen për ruajtjen e pyjeve dhe kullotave, si dhe të burimeve natyrore.**

Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore. Organi përfaqësues i qarkut krijohet me përfaqësues nga organet e zgjedhura të bashkive që e përbëjnë atë. Kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut zgjidhen nga këshilli i qarkut.

Sipas dispozitave të ligjit **Funksionet e Qarkut** janë ndërtimi e zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat shtetërore, në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj.

Po ashtu përcaktohet: Përbërja, krijimi, mënyra e organizimit, funksionimi, detyrat dhe kompetencat e **Këshillit të Qarkut**; numrit të anëtarëve; mbledhja e pare dhe mandati i këshilltarit të qarkut.

Në ligj cilësohen kompetencat e **Kryetari i këshillit të qarkut**, Sekretari i këshillit të qarkut, Kryesisë së këshillit të qarkut dhe se mbledhjet e Këshillit të Qarkut janë të hapura, si dhe seancat e këshillimeve dhe e drejta e publikut për t'u informuar.

Ndarja administrativo-territoriale në fuqi mund të riorganizohet me ose pa ndryshim të kufijve ekzistues të njësisë të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me interesat ekonomike e sociale, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore, për realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore ose për zbatimin e politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe më gjerë.

2.18 Ligj nr. 7895, datë 27.01.1995 “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

(Fl.Z.nr.2/1995), ndryshuar me: **Ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.1.1998; nr.8733, datë 24.1.2001;nr. 9017, datë 6.3.2003; nr. 9030, datë 13.3.2003; nr. 9086, datë19.6.2003; nr. 9188, datë 12.2.2004; nr. 9275, datë 16.9.2004; nr. 9686, datë 26.2.2007;nr. 9859, datë 21.1.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr.10186, datë 05.11.2009; nr.10440, date 07.07.2012;nr. 23/2012, datë 1.3.2012; nr.144, datë 2.5.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/2015, datë 5.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.7.2016; nr. 36/2017, datë 30.3.2017; nr. 89/2017, datë 22.5.2017;****Vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 46, datë 28.8.1997; nr.58, datë 5.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 19, datë 1.6.2011;nr. 47, datë 26.7.2012 dhe nr. 9, datë 26.2.2016. dhe ligjin nr. 44, datë 18.07.2019 (Fl.Z nr.131/2019).**

Në Kodin Penal të RSh parashihet si vepra penale që dënohet me gjobë ose burgim rastet:

- ✓ Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës, kur pasojat material nuk janë të lehta (*neni 150*).
- ✓ Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me zjarr (*neni 151*).
- ✓ Shpërdorimi i tokës në kundërshtim me destinacionin e saj. Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dhe Pushtimi i tokës (*neni 200*).
- ✓ Ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik (*neni 203*).
- ✓ Peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara apo/dhe Peshkimi i kryer me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj, (*204*).
- ✓ Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara (*neni 205*).
- ✓ Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr; dhe kur kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës; si dhe kur kjo vepër, ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet (*neni 206/a*).
- ✓ Shkatërrimi apo dëmtimi nga pakujdesia, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr; dhe kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, (*neni 206/b*).

Shtesa dhe Ndryshime thelbësore reflektohen në ligjin nr. 44, datë 18.07.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, ”Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, përfshijnë veprat penale që denohet me *gjobë ose burgim* në rastet:

- Ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, *dëmtimi i rëndë i kafshëve ose i bimëve*, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasi materiale në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara me ligj; kur është kryer në *zona të mbrojtura* si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës (*neni 201*).
- Grumbullimi, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e venddepozitimeve, si dhe veprimet e ndërmarra në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në *cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë*; kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve; ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit (*neni 201/a*).
- Transportimi i mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i Shqipërisë, në sasi jo të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-tjetrin, në shkelje të kërkesave të

legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente (*neni 201/b*).

- **Funksionimi i një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, të cilat shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë dëme të rënda jashtë impiantit në *cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë*; kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve; ka ardhur ose ka mundësi të vijë vdekja e personit; kryhet nga pakujdesia (*neni 201/c*).**
- **Prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm të rëndë në *cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë* (*neni 201/ç*).**

Për herë të parë në Kodin Penal përcaktohet se:

- **Vrasja, shkatërrimi, zotërimi, marrja e ekzemplarëve të *specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre*, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi *statusin e ruajtjes së specieve* (*neni 202*).**
- **Tregtimi i ekzemplarëve të *specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre*, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi *statusin e ruajtjes së specieve* (*neni 202/a*).**
- **Veprimet që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për *zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore* (*neni 202/b*).**